



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES KONSTITUTIVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 3, 4, 10, 14, 24 GUSHT
DHE MË 7 SHTATOR 2017**

**SA KONSTITUTIVNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 3, 4, 10, 14, 24 AVGUSTA
I 7. SEPTEMBRA 2017. GODINE**

**GUSHT/SHTATOR - AVGUST/SEPTEMBAR
2017**

Rendi i ditës

1. Formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve,
2. Dhënia e betimit të deputetëve,
3. Zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit.

Dnevni red

1. Formiranjë ad hoc komisijsë za verifikaciju kvoruma i mandata poslanika,
2. Polaganje zakletve poslanika,
3. Izbor Predsednika Skupštine i potpredsednika Skupštine.

Mbledhjen e drejtoi deputeti i Kuvendit, z. Adem Mikullovc.

KRYESUESI: Deputetë të nderuar,

Mirë se keni ardhur! Ju dëshiroj punë të mbarë të gjithëve dhe kam nderin që gjendem në këtë vend ku jam tash.

Kam nderin dhe kënaqësinë që me Rregullore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si deputeti më i moshuar i Legjislaturës së Gjashtë, ta kryesoj seancën konstitutive të Kuvendit të Republikës së Kosovës të dalë nga zgjedhjet e lira dhe demokratike, të mbajtura më 11 qershor.

Në drejtimin e mbledhjes do të më ndihmoj Teuta Rugova si deputetja më e re, e cila momentalisht nuk është këtu, por ndoshta vjen më vonë.

Njëkohësisht kam nderin e veçantë që t'i përshëndes dhe të ju dëshiroj mirëseardhje mysafirëve të nderuar, presidentin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi; përfaqësuesen e BE-së Natalya Apostollova; komandantin e KFOR-it, Giovanni Fungo; ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zotin Greg Delavi; ambasadorët përfaqësues të zyrave diplomatike në Kosovë; përfaqësuesit e bashkësive fetare në Kosovë, të gjithë të ftuarit e pranishëm në këtë seancë dhe mediet.

Përfitoj nga rasti të ju them se në bazë të nenit 8 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e partive politike që kanë fituar vende në Kuvend, të mbajtur më 25 korrik 2017, ka bërë përgatitjet për mbajtjen e seancës së Legjislaturës së Gjashtë me radhë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Me këtë rast, unë desha ta të jua lexoj edhe njëfarë lajmi shtesë, të ju njoftoj se deri në zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit dhe të nënkryetarëve të Kuvendit nuk zhvillohet kurrfarë debati, por nëse dikush kërkon ndonjë fjalë atëherë bëhet vetëm nëpërmjet kësaj foltores këtu.

Profesioni e bën të veten, ekziston deformimi profesional, prandaj unë e kam ndërmend të devijoj pak nga ky vend që po e mbaj dhe të ju recitoj një vjershë. Azem Shkreli na e ka lanë një vjershë shumë të keqe, domethënëse, por edhe shumë të mirë, kur thotë:

*“Ndalem dhe shikohem në pasqyrë drejt në sy,
dhe nuk di a me puth veten a me pështy”.*

Gjatë këtyre 18 vjetëve, shumë njerëz kanë kaluar nëpër këtë Kuvend që vërtet kanë merituar të pështyhen në fytyrë dhe kemi pasur shumë pak që kanë merituar të puthen në

fytyrë. Prandaj, sot Kosova gjendet këtu ku është. Pata qejf të jua përkujtoj këtu një citat...

(Duartrokitje)

Ju njoftoj se si pikë e parë e rendit të ditës është:

1. Formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve

Këtë mund ta bëjmë edhe pa qenë këta zotërinjtë, por do të kishte qenë mirë edhe ta bëjmë.

Në sallë janë të pranishëm 73 deputetë. Kuorumi ekziston, PAN-i nuk ekziston. Numrat janë. Kështu që ne mund të vazhdojmë të Deputetëve.

Ju njoftoj se në bazë të nenit 9, paragrafi 3 i Rregullores së Kuvendit, partitë politike të përfaqësuara në Kuvend do ta propozojnë nga një deputet në Komisionin e Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve.

Në Komision duhet të shqyrtohet dokumentacioni përkatës i zgjedhjeve të mbajtura më 11 qershor 2017, sipas rezultateve të zgjedhjeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), dhe t'i verifikojë të gjitha votimet që bëhen këtu në këtë Kuvend.

Prandaj, për anëtarët e këtij Komisioni i ftoj përfaqësuesit e partive politike që ta propozojnë nga një deputet.

Kryesuesi i Komisionit do të jetë nga subjekti me numrin më të madh të deputetëve - Koalicioni PAN, në nëse vijnë, diku duhet shënuar këta emra.

E ftoj Koalicionin PAN ta propozojë kandidatin e vet. Koalicioni PAN nuk ekziston.

Lëvizja “Vetëvendosje”, urdhëroni!

GLAUK KONJUFCA: Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” si anëtare të këtij komisioni e propozon deputeten e ardhshme, Albulena Haxhiu.

KRYESUESI: Koalicioni Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca Kosova e Re, urdhëroni!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Koalicioni ynë e propozon deputetin Armend Zemaj për këtë komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Iniciativa Qytetare - Lista serbe, Građanska Iniciativa Srpske liste? Nuk janë të pranishëm.

Partia Demokratike Turke?

FIKRIM DAMKA: Kosova Demokratik Türk Partisi, Müferra Şinik'i önermektedir.

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni "Vakat"?

RASIM DEMIRI: Koalicija "Vakat" predlaže poslanicu Dudu Balje.

KRYESUESI: Faleminderit!

Partia e Re Demokratike - Nova Demokratska Stranka?

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se gospodine predsedavajući, Nova demokratska stranka predlaže poslanicu Emilija Redžepi.

KRYESUESI: Hvala!

Partia e Pavarur Liberale - Samostalna Liberalna Stranka?

SLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem se i predložio, pošto sam sam, zato mogu ja da budem.

KRYESUESI: Nuk e di unë, unë punoj më fal. Unë shkoj vetëm sipas skenarit që ma kanë dhënë.

Një lajmërim i shkurtër: Meqenëse Teuta Rugova nuk erdhi në mbledhje, atëherë e ftoj Qëndron Kastratin që ta zëvendësojë Teutën.

Po vazhdojmë aty ku mbetëm.

Dugujem jedno obaveštenje vama gospodine, koji ste bili malo pre, ja vas još ne poznajem dobro, ja radim po scenariju koji sam dobio, i ni slovo van toga, ni unutar toga.

Partia Demokratike e Ashkalinjve të Kosovës?

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Meqenëse Partia Demokratike e Ashkalinjve të Kosovës e ka vetëm një përfaqësues në këtë Parlament, unë e propozoj vetveten, Danush Ademi, që të jem anëtar.

KRYESUESI: Faleminderit!
Partia Liberale Egjiptiane, a ekziston?

VETON BERISHA: I nderuar kryesues Mikullovc, Të nderuar kolegë deputetë, Më lejoni që në radhë të parë, në emër të Partisë Liberale Egjiptiane t'i uroj deputetët për mandatin e ri dhe uroj që Kosova të jetë në rrugë të mbarë dhe të zhvillohet.

Meqenëse unë jam i vetmi deputet i Partisë Liberale Egjiptiane, normalisht që detyrohem që të jem unë pjesë e Komisionit. Faleminderit! Urime!

KRYESUESI: Faleminderit!
Partia e Bashkuar Gorane - Jedinstvena Goranska Partija? Mungon.

Partia Rome e Bashkuar e Kosovës?

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar zoti kryesues! Të nderuar kolegë deputetë, Pasi edhe unë jam i vetmi përfaqësues i komunitetit rom nga Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, atëherë nuk me ngel asgjë tjetër veç ta propozoj vetveten. E propozoj Albert Kinollin për Komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Partia e Ashkalinjve në Integrim?

ETEM ARIFI: Faleminderit, kryesues! Të nderuar deputetë, Më lejoni që pasi edhe unë jam i vetmi prej Partisë së Ashkalinjve për Integrim deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, propozoj që të jem unë, Etem Arifi.

KRYESUESI: Faleminderit!
Përfitoj rastin të ju përsëris, në sallë gjenden 73 deputetë. Tash, lus deputetët që me ngritje të dorës të deklarohen për emërtimin e anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm.

Kush është për, le të urdhërojë. Vajza numëroni, mbani sa më gjatë duart, ju lutem, deri sa të numërohem.

Të votojmë tash kush është kundër, ju lutem! Unë po tregoj, se nuk po e lëshoj dorën. A ka dikush që abstenon, që thotë nuk dua të përzihem në këtë punë. Nuk ka!

73 deputetë kanë qenë të pranishëm, 72 kanë votuar për, që do të thotë Komisioni u zgjodh.

Konstatohet se u bë emërtimi i këtij Komisioni dhe e lus Komisionin që të largohet dhe ta përgatisë materialin për të na raportuar neve.

E jap një pauzë prej 30 minutave, shihemi dhe e dëgjojmë raportin e Komisionit.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton deputeti i Kuvendit, z. Adem Mikullovi.

KRYESUESI: Regjia, bjeri ziles, ju lutem!

Le të vijmë të gjithë në sallë!

I ftojme deputetët që t'i zënë vendet, të vazhdojmë mbledhjen, ju lutem!

Ju lutem, zotërinj deputetë, zini vendet, po e vazhdojmë seancën! E ftoj kryesuesin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandatit të Deputetëve që ta paraqesë raportin e komisionit.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Përshëndetje për të gjithë,

Kolegë të nderuar,

Deputete dhe deputetë,

Mysafirë të kësaj seance konstitutive,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Komisioni në praninë e 8 subjekteve politike dhe koalicioneve, në mënyrë kolegjiale do të paraqesë në pika të shkurtra atë që u dakorduar edhe sipas Rregullores së punës së Kuvendit, por edhe qartësisht edhe të situatave që kërkohet në bazë të mandatit tonë për verifikimin e përkohshëm, domethënë të kuorumit dhe të mandateve dhe ta sjellim këtu para jush.

Komisioni kërkon nga seanca, nga deputetët e pranishëm nëse ekziston kuorumi i tanishëm që të kërkohej plotësimi i komisionit edhe me subjektet e tjera parlamentare që erdhën pas votimit gjatë pranisë sonë ulur këtu në seancën plenare dhe të bëhet tërheqja edhe njëherë, të kompletohet, të verifikohet lista e mandateve e ardhur nga KQZ-ja nëpërmjet Presidentit të vendit dhe ne do ta sjellim para jush që të fillojmë procedurat e betimit të Legjislaturës VI të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kërkoj nga kryesuesi i seancës që ta nxjerrë këtë propozim dhe të plotësohet edhe nga subjektet e tjera politike që erdhën në këtë moment, pas 15 minutave ne do të kthehemi të kompletuar me listën verifikuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Të shohim, së pari, sa deputetë i kemi në sallë?

Në sallë gjenden 80 deputetë.

Ju lutem, i thërras deputetët të votojnë a e pranojnë propozimin e kryetarit të komisionit që e mbajti para 5 minutave?

Kush është për, le ta ngrejë dorën?

Kush është kundër? Nuk ka kundër!

A ka abstenim? Nuk ka as abstenim!

Atëherë, të gjithë 80 deputetët e pranojnë propozimin e kryetarit të komisionit.

E ftoj iniciativën qytetare Lista serbe - Građanska Inicijativa Srpske liste, ta japë emrin e kandidatit të vet!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedavajući!

Srpska lista za člana ad-hoc Komisije za verifikaciju mandata predlaže Jelenu Bontić.

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj Partinë e Bashkuar Gorane, se ata erdhën në ndërkohë.

ADEM HODŽA: Poštovanje, predsedavajući!

Kolege poslanici,

Jedinstvena Goranska Partija predlaže Jelenu Bontić. Hvala!

KRYESUESI: Pas këtyre dy propozimeve që i dhamë, jemi të detyruar që edhe një herë komisioni komplet të mblidhet dhe t'i verifikojë dhe të votohet.

Kush është për? Sa po shoh, të gjithë.

A ka dikush kundër? Nuk ka kundër.

Abstenon ndokush? Nuk abstenon askush.

Do të thotë, me 80 vota për aprovohet. Tash duhet prapë ta lusim komisionin që të dalë në një pauzë të shkurtër 15 minuta për ta kompletuar këtë listë të këtij komisioni. Kërkoj falje!

E lus komisionin të ngutet sa më shpejt, s'ka shumë punë, 15 minuta!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton deputeti i Kuvendit, z. Adem Mikullovc.

KRYESUESI: Ju lutem, zini vendet! Kthehuni në sallë, po e vazhdojmë mbledhjen.

Regjia, ju lutem, bjeri ziles!

Deputetë të nderuar,

Më duhet të them se për shkak të jokorrektësisë lidhur me ardhjen me kohë në mbledhje, detyrohem që për herë të tretë ta votojmë komisionin që e votuam dy herë, një herë sa ishim, mandej për Listën Serbe, tash për PAN-in. Me keqardhje, ne duhet ta kalojmë krejt këtë procedurë edhe një herë.

Kurrfarë diskutimi nuk ka. Ftoj përfaqësuesin e PAN-it të dalë dhe të japë emrin e kandidatit të Komisionit Verifikues.

ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që në fillim, t'u uroj të gjithë juve për zgjedhjen për deputetë të Kuvendit të Kosovës. Besoj se do të kemi një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë dhe dua t'i falënderoj të gjithë deputetët që kanë qenë mandateve të kaluara, që i kanë shërbyer vendit!

Të nderuar përfaqësues të ambasadave të akredituara në Kosovë, të Ambasadës Amerikane, të Zyrës së BE-së,

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

(Pauzë)

KRYESUESI: I nderuar Hoxha, po presim të na e jepni emrin e kandidatit, ju lutem!

ENVER HOHAJ: Zoti kryesues,
Vetëm le të ulen deputetët.

KRYESUESI: Ju lutem, për pak qetësi në sallë, ta dëgjojmë emrin e kandidatit të PAN-it.

ENVER HOXHAI: Zoti kryesues, faleminderit!

Meqë të gjithë deputetët e koalicionit, të Partisë Demokratike të Kosovës, të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe të “Nismës” janë në vend, më lejoni që në emër të këtij koalicioni ta propozoj zotin Zenun Pajaziti si anëtar të Komisionit Verifikues.

KRYESUESI: Faleminderit! Kush është për këtë propozim? Nuk po të dëgjoj, s’po të marr vesh!

(Ndërprerje e incizimit)

Ftoj edhe një herë Partinë e Bashkuar Gorane që ta japë emrin e kandidatit, se nuk bën të propozohet vetja.

ADEM HODŽA: Ja se još jednom izvinjavam svima vama, kolege!

Predsedavajući,

Iz demokratskih principa ja sebe nisam predložio, ali s obzirom da postoji mogućnost, ja predlažem samog sebe, odnosno Jedinствена Goranska Partija predlaže Adema Hodžu. Hvala!

KRYESUESI: A pajtoheni me këtë propozim? Kush është për, le të ngrejë dorën për të dy propozimet, edhe të parën, edhe të dytën. Po shihet se shumicë panë për po. Abstenim? Kundër? Kuorumi është... veç një kundër. 114 kanë votuar për.

Komisioni tërhiqet. Armend, të lutem. mundohu sa më shkurt, sa më shpejt. 115 i kemi, 114 kanë votuar, një s’ka votuar, s’di pse!

(Ndërprerje e incizimit)

Regjia, ju lutem, bjeri ziles që ta vazhdojmë seancën! E ftoj kryesuesin e komisionit që të dalë e të raportojë para Kuvendit.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë, pasi që pati edhe ardhje të reja të kolegëve deputetë. Seanca konstitutive e legjislaturës VI të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve, në mënyrë kolegjiale edhe jashtë zhvillimeve të tjera, u vendos që ta lexojmë këtë raport. Por, ajo që na duhet dhe është kërkesë edhe e komisionit është verifikimi edhe një herë i kuorumit.

Të pranishëm ishin 115 në momentin e votimit. Ju kisha lutur, nëse ka ardhje të reja të deputetëve, sekretaria ta evidentojë dhe ta japin numrin final. Po që se bën edhe një minutë a dy dhe të verifikojë kryesuesi i seancës, deputeti më i vjetër sipas moshës.

KRYESUESI: Ta shohim kuorumin, sa deputetë janë në sallë?

Janë gjithsej 120 deputetë në sallë.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, deputet më i vjetër! Faleminderit, sekretari!

Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i themeluar me vendim të seancës plenare më 3 gusht 2017, në përputhje me mandatin e tij Kuvendit ia paraqet këtë:

R A P O R T

Në mbështetje të nenit 9.4 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve në mbledhjen e mbajtur më 3 gusht 2017 e shqyrtoi dokumentacionin përkatës zgjedhor si vijon:

1. Njoftimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me rezultatet e zgjedhjeve 2017 për Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe
2. Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 1233, të datës 8. 7. 2017 për certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 11 qershor 2017, së bashku me listën përfundimtare të kandidatëve.

Komisioni në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit të cekur më lart konstaton:

Në Legjislaturën VI për Kuvendin e Republikës së Kosovës janë certifikuar 120 deputetë nga partitë politike, koalicionet, iniciativat qytetare që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e mbajtura më 11 qershor 2017, si vijon:

1. Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma për Kosovën, Partia e Drejtësisë, Lëvizja për Bashkim, Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës, Partia Konservatore e Kosovës, Alternativa Demokratike e Kosovës, Republikanët e Kosovës, Partia e Ballit, Partia Social-Demokrate dhe Balli Kombëtar i Kosovës me 39 deputetë;

2. Lëvizja “Vetëvendosje”, 32 deputetë;

3. Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca Kosova e Re 29 deputetë;

4. Građanska Iniciativa Srpska lista, 9 deputetë;

5. Kosova Demokratik Tyrk Partisi, 2 deputetë;

6. Koalicija “Vakat”, 2 deputetë;

7. Nova Demokratska Stranka, 1 deputet;

8. Samostalna Liberalna Stranka, 1 deputet;

9. Partia Demokratike e Ashkanlinjve të Kosovës, 1 deputet;

10. Partia Liberale Egjiptiane, 1 deputet;

11. Jedinstvena Goranska Partije, 1 deputet;

12. Partia e Ashkalinjve për Integrim, 1 deputet;

13. Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, 1 deputet.

2. Komisioni ka konstatuar se në seancën e sotme dhe pas verifikimit final janë të pranishëm 120 deputetë, andaj seanca konstitutive mund t'i vazhdojë punimet sipas agjendës së paraparë dhe rregullave të procedurës.

Faleminderit! Urime!

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj deputetët të votojnë lidhur me aprovimin e raportit të komisionit. Kush është për? Faleminderit! Kush është kundër? S'ka asnjë. A abstenon dikush? Nuk ka. Konstatojmë që Kuvendi miratoi raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe Mandateve të Deputetëve me 120 deputetë të pranishëm.

2. Dhënia e betimit të deputetëve

Ju njoftoj se betimi solemn i deputetëve është një veprim i paraparë me Kushtetutë dhe me Rregulloren e Kuvendit.

Tekstin e deklaratës së betimit e ka secili deputet para vetes dhe të njëjtin duhet ta nënshkruajë personalisht. Për ta përmbushur këtë detyrim, lus deputetët të ngrihen në këmbë, ta dëgjojnë tekstin që do ta lexoj unë dhe vetëm në fund, të gjithë së bashku shqiptojmë fjalën “Betohe” dhe e nënshkruan secili fletën e betimit që e ka para vetes. Ju lutem, ngrihuni në këmbë!

“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do të përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj. Do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe integritetin institucional të Kosovës dhe për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, të parapara me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane. Betohe me zemër!”

TË GJITHË: “Betohe!”

KRYESUESI: Lus deputetët, personalisht secili ta nënshkruajë deklaratën që e ka para vetes dhe t’ia japë shërbimit këtu.

3. Zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit

Të nderuar deputetë,

Në bazë të nenit 67, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar, andaj në bazë të nenit 67, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, grupi më i madh parlamentar është koalicioni parazgjedhor me numrin më të madh të deputetëve, i dalë nga zgjedhjet e mbajtura më 11 qershor 2017, e që është Koalicioni PAN, i cili propozon deputetin për kryetar të Kuvendit.

Ju njoftoj që kryetari i Kuvendit zgjidhet me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, së paku 61 vota duhet t’i ketë. Ftoj përfaqësuesin e PAN-it, le ta marrë fjalën dhe të propozojë kandidatin!

ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryesues, deputet më i vjetër,

E nderuar zonja kryesuese, deputete më e re,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ne si koalicion i përbërë nga Partia Demokratike e Kosovës, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe nga Nisma kërkojmë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për 2 orë, meqë na duhen konsulta shtesë me partnerët e koalicionit dhe pas dy orësh, në orën 14, do të kthehemi në sallë dhe ta japim kandidatin tonë për kryetar të Kuvendit. Zgjedhja e kryetarit dhe e nënkryetarëve nënkupton edhe hapat e tjerë shtesë për formimin e institucioneve, në këtë drejtim ne kemi nevojë për një pauzë. Është edhe kohë e drekës dhe pasi ta kryejmë drekën do të kthehemi në sallë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju lutem! Unë personalisht, a mund ta nxjerr në votim, nuk pajtohem me këtë propozim.

Pika e parë, erdhët me vonesë, ju e vonuat mbledhjen.

E dyta, me skenarin e Kuvendit të kësaj mbledhjeje nuk ka pauzë. Keni pasur mjaft kohë të merreni vesh dhe të bëni koalicione e të bëni biseda. Kështu që, unë propozoj të refuzohet ky propozim, por nëse doni, e hedhim edhe në votim.

Kush është për atë që propozimi i PAN-it të aprovohet ose jo?

Kush është për?

Ju lutem, vajza, numërojini votat!

Tash propozojmë që të votojë kush është kundër, pastaj e shpallim rezultatin. A ka abstenim? S'ka.

Kështu është raporti: për propozimin janë 60, por edhe për kundërpropozim janë 60.

Kur është rezultati i barabartë, propozimi bie poshtë dhe nuk aprovohet. Urdhëroni!

ENVER HOXHAI: Zoti kryesues Mikullovc,

Ne e dimë që je deputet i vjetër, po pakës këtë vjetërsinë tënde po e interpreton shumë në rrafshin tradicional. Ne jemi deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe qëllimi ynë është që t'i formojmë institucionet e Kosovës dhe kërkesa jonë që ne të kemi 2 orë pauzë me qëllim që brenda dy orësh të dalim me kandidatin tonë për kryetar, i takon frymës parlamentare dhe ju jeni "i pari i familjes" këtu, por jeni vetëm një udhëheqës i seancës, kështu që kërkoj nga ju të krijoni situatë, e cila ia mundëson këtij vendi që të konstitutohet Kuvendi i Kosovës.

Përndryshe, ne e kemi qëndrimin shumë të qartë. Edhe vota u pa që 60 deputetë janë për, 60 deputetë janë kundër. Ju kisha lutur që të mos e udhëhiqni seancën në pafundësi duke bërë shkelje të Rregullores dhe të procedurave në fuqi.

KRYESUESI: Me leje, Glauk Konjufca, urdhëro! Pa ofendime personale, ju lutem!

GLAUK KONJUFCA: Ajo që kërkoi zoti Hoxhaj sot është që dy muaj që i patën deri tash për t'i bërë marrëveshjet dhe pazaret që gjithmonë i dinë më së miri dhe ua kanë marrë dorën, tha: "Po na nevojitet këtyre dy muajve t'ua shtojmë edhe dy orë". Kjo është joserioze.

Në të vërtetë, ajo çfarë tregon kërkesa e tyre është më shumë mungesa e deputetëve të tyre për të zgjidhur kryetarin e ardhshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Të gjithë e dimë që ky kandidat do të jetë për afërsisht, ashtu siç kanë shpjeguar zyrtarët e tyre, Kadri Veseli, dhe dihet tashmë që shumica e deputetëve të këtij Kuvendi do të votojnë kundër kësaj figure kontroverse politike. Pikërisht për këtë arsye, këtyre nuk do t'u mjaftojnë as dy orë të tjera, pas dy orëve do t'i kërkojnë edhe dy orë të tjera dhe nuk do të ndalen kështu, për ta shtyrë konstitutimin e institucioneve të Republikës së Kosovës.

Zoti Hoxhaj, ju nuk e keni për t'i konstituar institucionet, ju e keni këtë detyrë për ta shtyrë konstitutimin e institucionit. Nëse nuk ju kanë dalë dy muaj, cilin argument e keni që mund t'ju dalin dy orë tash? Pra, krejt çka po bëni është që të merrni kohë vazhdimisht dhe që të bllokoni konstitutimin e institucioneve të Republikës së Kosovës. Nëse jeni për t'i themeluar institucionet, urdhëroni vendoseni kandidatin tuaj dhe le ta shohim a po e votojnë deputetët e këtij Kuvendi kryetarin e ardhshëm të propozuar nga Koalicioni PAN.

AVDULLAH HOTI: Kryesues,

Më lejoni t'ju përshëndes edhe një herë të gjithëve.

Rregullorja e punës së Kuvendit është e qartë, deputetët që janë më gjatë në Kuvend e dinë më mirë se sa unë këtë. Më vjen keq që u desh të shtyhet për dy orë seanca e Kuvendit që të fillojmë dhe kërkojmë nga kryesuesi që ashtu siç e ka udhëhequr deri tash seancën me përgjegjësi, të çojë deri në fund këtë skenar që e ka përpara vetes, që bazohet në Kushtetutë, në ligjin dhe Rregulloren e punës së Kuvendit.

Jemi në fund të afatit kushtetues për të konstituar Kuvendit. Mua më vjen keq që edhe presidenti i vendit është involvuar në këtë proces për të shtyrë konstitutimin e Kuvendit dhe të institucioneve. Duhet ta keni të qartë të gjithë që vetëm shumica parlamentare i konstituton institucionet e vendit të dala nga zgjedhjet demokratike.

Ne do të insistojmë në këtë formë të punës së Kuvendit dhe lus kryesuesin që të jetë i qartë, i prerë në udhëheqjen e kësaj seance. Faleminderit!

KRYESUESI: Hajde edhe një herë dhe të mos e zgjasim shumë, se këtu s'ka shumë komente, këtu flet ligji.

ENVER HOXHAI: Zoti Mikullovc, po më pëlqen raporti juaj me kohën, është goxha interesant, por më lejoni të flas me fakte dhe jo me interpretime. Dhe, fakti është ky: është aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të vitit 2014, i cili të drejtën ekskluzive për ta... të flas... ta formuloj... nuk keni nevojë me gjuhë trupi... ta formuloj me gojë... i cili të drejtën ekskluzive ia jep koalicionit tonë parazgjedhor.

Unë kërkova politikisht dhe me mirësi që neve na duhen dy orë pauzë. Nëse ka mbetur puna në dy orë të çmuara tuajën që e keni të pamundur t'i gjeni, atëherë do të thotë, unë po them, po e interpretoj se si është gjendja...

Zoti kryesues, nëse nuk krijon kushte juridike për ta zgjedhur dhe për ta propozuar kandidatin për kryetar të Kuvendit, ne mund të vazhdojmë në pafundësi, por po kërkoj nga ju dy orë pauzë, na duhen dy orë pauzë.

KRYESUESI: Urdhëro, veç me leje, me radhë. Nuk ka debat. Kjo është e fundit, në këtë çështje nuk ka debat.

BESA GAXHERI: I nderuar kryesues,
Të nderuar kolegë deputetë,
Ne propozimin e Koalicionit PAN e votuam. Dhe, unë dola këtu për ta konfirmuar atë që pashë me sy, se për shtyrjen e seancës ishin 59 deputetë. Ju lutem, deputeti Milaim Zeka nuk ka marrë pjesë në votim. Unë e kam përcjellë dhe 59 deputetë janë për, 60 janë kundër, këtu s'kemi çka të diskutojmë më tutje, ne votuam. Ju lutem, administrata, po qe nevoja edhe me incizim le ta lëshojnë dhe le ta shohin. 59 janë për, 60 janë kundër, një deputet nuk ka votuar.

KRYESUESI: Me leje! Unë nuk kisha vazhduar debatin. PAN-i, a e keni kandidatin për kryetar të Parlamentit, a nuk e keni? Kjo është pyetja. Urdhëro, Milaim.

MILAIM ZEKA: Është e vërtetë që unë personalisht nuk shoh kurrfarë arsyeje të shtyhet dy orë, as dy minuta. Nuk shoh arsye ne të turpërohemi para Korit Diplomatik e të bëjmë hajgare, të fillojë seanca me vonesë. Domethënë, këto janë hajgare prej fillimit. Megjithatë, unë kam votuar, por mendoja a ta çoj të djathtën a të majtën, kam votuar me vonesë. Kështu që vota ime është për shtyrjen, në mënyrë që të mos bllokohet procesi.

Besë, unë edhe një herë po them, në qoftë se brenda dy orësh nuk vazhdojnë proceset, atëherë unë e kam qëndrimin tim, e kam rezonimin tim dhe të mos e bllokojmë procesin, po shkojmë po hamë drekë...

KRYESUESI: Që je vonuar ti, Milaim, votat janë numëruar, votat janë konfiguruar... Rezultati është 60:60. Propozimi anulohet sipas Kushtetutës. Me kaq unë e mbyll këtë mbledhje.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, në orën 15:00

Mbledhjen e drejton deputeti i Kuvendit, z. Adem Mikullovc.

KRYESUESI: Meqenëse koha po kalon, e këta zotërinjtë e PAN-it nuk janë duke ardhur, unë i thërras kryetarët e grupeve parlamentare të “Vetëvendosjes” dhe Lidhjes Demokratike dhe të AKR-së të bisedojnë nëse do ta vazhdojmë mbledhjen apo ta ndërpresim. Kuorum nuk ka.

Në sallë janë 58 deputetë, tash erdhi edhe një, 59 gjithsej.

A do të paraqiten shefat e grupeve për ta dhënë mendimin e vet, ju lutem!

GLAUK KONJUFCA: Kur zoti Hoxhaj para tri orësh i kërkoi dy orë, unë dola në këtë foltore dhe thash që kërkesa e tij është e pasinqertë. Nuk është puna te dy orët që ai po i kërkon, por është një dhimbje më e madhe, është dhimbja te mungesa e numrave për ta votuar Kadri Veselin për kryetar të Kuvendit të Kosovës.

Tash, sot në mbledhjen konstituive të Kuvendit po qartësohet një gjë, që institucionet nuk po mund të themelohen dhe Republika e Kosovës ka mbetur peng për shkak se një koalicion i tërë, i cili ka marrë më së shumti vota në zgjedhje, është barrikaduar përreth një figure, e cila është e papranueshme për shumicën e deputetëve të këtij Kuvendi. Kjo figurë është Kadri Veseli, i cili nuk ka shans të bëhet kryetar i këtij Kuvendi, meqenëse ne mendojmë që kryetari i Kuvendit duhet të jetë një figurë unifikuese, pa njolla, ndërsa Kadri Veseli e paraqet të kundërtën.

Është një figurë me shumë pikëpyetje, të cilat duhet të zbardhen në të ardhmen.

Kjo është arsyeja pse s’po mund të themelohen institucionet e Republikës së Kosovës.

Ne jemi të hapur si “Vetëvendosje”, por me sa e kam kuptuar edhe qëndrimin e LDK-së është pak a shumë aty, që ne do të ishim të hapur nëse ky koalicion do ta ndërronte kandidatin për kryetar të Kuvendit, që ta vendoste për kandidat apo kandidate një figurë, e cila është e pranueshme dhe është bashkuese ndërmjet grupacioneve apo ndërmjet grupeve parlamentare në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Përderisa ata nuk e ndërrojnë kandidatin, përderisa të jetë Kadri Veseli, qëndrimet tona do të jenë të njëjta: “Vetëvendosja nuk e voton Kadri Veselin në asnjë mënyrë, por nëse Partia Demokratike dhe PAN-i do të insistojnë deri në fund me kryeneçësi të pashpjegueshme që të barrikadohen përreth figurës së Kadri Veselit, duke e bërë Kadri Veselin më të rëndësishëm se Republikën, atëherë ata duhet ta marrin po ashtu edhe përgjegjësinë politike pse nuk po themelohen institucionet e Republikës dhe pse një shtet i tërë ka mbetur peng i një emri, që quhet Kadri Veseli.

Prandaj, meqë po shihet edhe në këtë Kuvend që mund të jemi edhe shumicë parlamentare, unë propozoj që të mos humbim kohë me themelimin e institucioneve të Kosovës.

Qëndrimi i Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” është që nesër të thirret seanca e radhës dhe që Koalicioni PAN të shfaqet këtu, të jetë i përgjegjshëm, të marrë pjesë në seancë konstitutive dhe ta propozojë një kandidat të pranueshëm për kryetar të ardhshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: E dëgjuam kryetarin e Grupit të “Vetëvendosjes”. Zoti Avdullah, Lidhja Demokratike dhe AKR-ja, urdhëroni!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Është seanca e dytë që po e mbajmë gjatë një dite. Me vullnetin tonë të dy grupeve parlamentare, unë sot i përfaqësoj LDK-në, AKR-në dhe Alternativën kur flas para Kuvendit të Kosovës.

Është për keqardhje që një shumicë, e Gjykata Kushtetuese në ato vendime të vitit 2014 e ka barrikaduar të drejtën e tyre që vetëm nga ai grup të vijë propozimi për kryetar të Kuvendit, që bie ndesh me parimin e demokracisë që institucionet të themelohen vetëm nga shumica parlamentare, nga ata që i përfaqësojnë qytetarët e Kosovës, sigurisht ne do të sillemi në përputhje me vendimet e Gjykatës Kushtetuese, por nuk do të heqim dorë nga e drejta jonë si shumicë në këtë Kuvend për t’i themeluar institucionet e ardhshme.

Unë të ftoj kryesues që sa më parë të thirret seanca e ardhshme dhe e ftoj Koalicionin PAN që të jenë këtu të pranishëm për ta dhënë kandidatin e tyre për kryetar të Kuvendit,

dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës, besoj të dy grupeve, do të sillen sipas dhe do të votojnë sipas vullnetit të tyre, por qëndrimi ynë është i qartë, e besoj edhe i “Vetëvendosjes”, që për neve është i papranueshëm kandidati që është përfolur deri më tash, edhe pse nuk e dimë nëse është i sigurt apo jo kryetari i PDK-së, sepse është person i padenjë për të udhëhequr me Kuvendin e Kosovës. Për dy vjet e gjysmë të udhëheqjes së Kuvendit e kemi parë se si është menaxhuar institucioni më i rëndësishëm i shtetit të Kosovës.

Për kandidatura tjera, ne, veç e veç, do t’i shqyrtojmë ato kandidatura dhe besoj që do ta arrijmë konsensusin e nevojshëm në këtë Kuvend se kë e dëshirojmë ta shohim në krye të këtij institucioni. Faleminderit për durimin të gjithë të deputetëve që kanë qëndruar, edhe para dite, edhe tash, edhe pse nuk e kemi prezent deputetët e Koalicionit PAN.

Kryesues, kurdo që e shihni të nevojshme, thirrreni seancën e radhës, ne do të jemi prapë këtu për ta treguar vendosmërinë tonë për t’i themeluar institucionet e vendit sa më parë që të jetë e mundshme. Faleminderit!

KRYESUESI: I dëgjuam kryetarët e dy grupeve parlamentare dhe, sipas të gjitha gjasave, kjo seancë duhet të vazhdohet nesër, në orën 10:00, nëse pajtoheni.

Faleminderit për durimin! Shihemi nesër!

* * *

E premtë, më 4 gusht

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 3 gusht

Mbledhjen e drejton deputeti i Kuvendit, z. Adem Mikullovc.

KRYESUESI: I ftoj deputetët të ulen nëpër vendet e tyre që ta konstatojmë kuorumin, kush ka ardhur dhe kush s'ka ardhur.

Regjia, ziles të lutem, le të vijnë deputetët në sallë!

Në sallë janë të pranishëm 53 deputetë, do të thotë s'kemi kuorum. PAN-i nuk ka ardhur, prandaj po e jap një pauzë prej 15 minutave. Po presim 15 minuta, nëse vijnë, mirë - nëse s'vijnë, përshëndetemi.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton deputeti i Kuvendit, z. Adem Mikullovc.

KRYESUESI: Në sallë janë 58 deputetë. PAN-i e ka dërguar përfaqësuesin e vet. Unë i ftoj kryetarët, ju lutem, kryetari i Grupit të "Vetëvendosjes", kryetari i Lidhjes Demokratike dhe të AKR-së, të takohen që të merremi vesh për mbajtjen e seancës së ardhshme. Urdhëro!

MILAIM ZEKA: Zoti kryesues!

Unë nuk jam këtu si përfaqësues i PAN-it. Unë kam ardhur këtu që të tregoj që jam ndryshe, që të tregoj që unë nuk jam numër, por jam deputet, dhe që të tregoj se logjikën të cilën e ka mbjellë "Vetëvendosje" në mandatin e kaluar, logjikën e bojkotit, nuk është mirë që ta ndjekë PAN-i.

Unë sot kam ardhur pa gaz lotsjellës, por sidoqoftë më vjen mirë për reformat që i ka bërë "Vetëvendosje". Duhet të ulemi të shikojmë cilat pika na bashkojnë. Jam plotësisht dakord që ky shtet është i kapur, i kapur shumë, dhe duhet të shkapet, por megjithatë ka ardhur momenti që ne duhet të ulemi të bisedojmë për t'i zhbllokuar proceset. Për këtë kam ardhur sot, sepse jam përgjegjës para 12 100 mijë votuesve që ma kanë dhënë votën. Për mua, votuesi është mbi PAN-in dhe mbi çdo gjë tjetër.

KRYESUESI: Në ndërkohë, në sallë janë 60 deputetë. E përsëris, ju lutem, të takohen kryetarët e grupeve parlamentare. Urdhëro, Glauk!

GLAUK KONJUFGA: Dje, Grupi Parlamentar, të cilit, sipas një aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese, i takon zgjedhja e kryetarit të Kuvendit, pra u takon atyre që ta paraqesin

kandidatin për kryetar të ardhshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës i kërkoi dy orë shtesë për seancën e djeshme, por nuk erdhën vetë as pas tri orësh. Kjo na bëri të kuptojmë që problemi kryesor i tyre është mungesa e votave për ta zgjedhur Kadri Veselin kryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kjo pamundësi për ta zgjedhur atë kryetar i ka arsyet e veta. Arsyeja kryesore është që Kadri Veseli nuk e përbën një figurë të denjë dhe një figurë unifikuese politike, e cila do të ishte si njëfarë lloj ure lidhëse ndërmjet grupeve të ndryshme parlamentare këtu në Kuvend. Kështu që tashmë është bërë e qartë që ky njeri nuk mund të zgjidhet kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Lëvizja “Vetëvendosje” e ka përcjellë dhe edhe një prononcim të zotit Veseli, sipas të cilit ai është i gatshëm të tërhiqet nga kandidimi për kryetar të Kuvendit, e kjo do t’i bënte shumë mirë Kosovës. E ftojme atë që ta mbajë këtë premtim, mirëpo Kadri Veseli nuk është në gjendje që të na kushtëzojë për votimin e Qeverisë të ardhshme të Republikës së Kosovës.

Qeverinë duhet ta bëjë kjo përbërje e Parlamentit që jemi këtu sot, pra Lëvizja “Vetëvendosje” me Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe me pakicat, të cilat natyrisht do t’i bashkoheshin një mazhorance të konfirmuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Qytetarët dhe sot po e kuptojnë se kush është bllokuesi i vërtetë i themelimit të institucioneve në Kosovë. Janë ata që nuk janë të pranishëm këtu sot, për ne është shumë e qartë. Pse ata nuk janë të pranishëm sot është se janë barrikaduar në mënyrë të verbër prapa një figure politike, e cila nuk i ka sjellë asnjë të mirë Kosovës. Ata e kanë në dorë zhbllokimin e institucioneve të Republikës së Kosovës. Nëse e ndryshojnë, kandidatin atëherë të gjithë ne që jemi këtu do të jemi të gatshëm ta shqyrtojmë një propozim të ri që ai të votohet, ta zërë vendin e kryetarit të Kuvendit dhe të ecim përpara kështu në fazat, të cilat na presin, e faza e ardhshme është krijimi i Qeverisë së Republikës të Kosovës.

KRYESUESI: Urdhëro, Avdullah!

AVDULLAH HOTI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Përfaqësues të pranishëm të ambasadave,

Është për keqardhje, po mblidhemi për të tretën herë këtu në Kuvendin e Kosovës për t’i themeluar institucionet e vendit, dhe ata që e kanë të drejtën sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, sado që është i padrejtë, por të cilin kemi vendosur ta respektojmë të gjithë si koalicion i LDK-së, AKR-së dhe Alternativës, t’i qëndrojmë mbrapa atij vendimi, të

jemi çdoherë në seancë kur kryesuesi i seancës, në bazë të drejtës që ka për t'i thirrur seancat e Kuvendit të Kosovës, të jemi në sallë në kohën që është ftuar seanca nga ai.

Më vjen mirë që po e shoh së paku një deputet të Koalicionit PAN, dhe unë pres që kurdo që të thirret seanca e ardhshme nga kryesuesi të shohim më shumë deputetë të ndërgjegjshëm të këtij koalicioni për të qenë të pranishëm në sallë, për ta respektuar vullnetin e qytetarëve të Kosovës, për t'i konstituuar sa më parë institucionet e vendit.

Unë pres që herën tjetër, kurdo që të caktohet kjo seancë, t'i shohim këta në sallë, t'i japin propozimet e tyre. Qëndrimet politike i kemi të qarta si koalicion. Kë votojmë dhe kë s'e votojmë, ne vazhdojmë të qëndrojmë në vendimin si koalicion që nuk e votojmë kryetarin e PDK-së për kryetar të Kuvendit. I kam dëgjuar edhe unë deklaratimet e tij dje, që është i gatshëm të heqë dorë, në fakt deklarimi i tij duhet parë si dorëzim i tij para vullnetit të deputetëve të Kuvendit të Kosovës për t'u zgjedhur në krye të këtij institucioni.

Unë pres që ata t'i shohim në sallë, ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre kushtetuese për ta dhënë kandidatin e tyre dhe ne do ta shqyrtojmë me kujdes çfarëdo kandidature që jepet nga ky koalicion.

Është e pafalshme që për një muaj e sa institucionet e vendit nuk krijohen, duke e monopolizuar të drejtën e tyre. Ne duhet t'u nënshtrohemi rregullave demokratike, që nënkupton se shumica i themelon institucionet. Ne jemi të vendosur që ta respektojmë të drejtën e tyre me atë vendim dhe presim që sa më parë që ata t'i shohim në sallë, ta japin propozimin e tyre dhe të shkojmë përpara në themelimin e institucioneve.

Unë e ftoj kryesuesin që të kryejë konsultimet e nevojshme për ta thirrur seancën tjetër sa më parë që është e mundur që ta çojmë përpara themelimin e institucioneve të vendit dhe çuarjen në vend të vullnetit të qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Më fal, të lutem, mendimi juaj - kur ta vazhdojmë seancën? A keni propozim, apo po merreni vesh me Glaukun?

Atëherë, urdhëro!

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Në cilësinë e kryesuesit të seancës, unë mendoj, se e di që vendimi i Gjykatës Kushtetuese u jep të drejta joproportionale me kryetarin e seancës, por mendoj që ju ta luani rolin e kryetarit të seancës, duke u konsultuar me grupet parlamentare dhe propozoj që në orën 12:00 ju t'i thërrisni të gjitha grupet parlamentare, jo vetëm grupet LDK,

AAK, Alternativa dhe “Vetëvendosje”, por të gjitha grupet parlamentare, dhe nga ajo mbledhje të dilni me një propozim për seancë brenda ditës së sotme.

Pra, në këtë metodologji unë mendoj që ju e luani një rol pak më lart se sa një palë, sepse ata po të pretendojnë që ju jeni bërë palë, edhe pse normalisht ju jeni deputet dhe po e udhëhiqni shumë mirë seancën. Mendoj se në këtë mënyrë ju e luani rolin e kryetarit të Kuvendit, edhe pse nuk e keni, por jeni shumë pozitivist në qasjen tuaj.

Pra, unë propozoj që në orën 12:00 të mbahen takimi i kryesuesit të seancës me grupet parlamentare dhe nga ky takim ju dilni me një propozim për seancë pasdite, ndoshta në orën 14:00 ose 15:00, kur ju ta shihni të arsyeshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Mua po më pëlqen propozimi, por unë dua të konsultohem me Glaukun, me shefin tim. Unë jam amator këtu, më fal! Edhe me Avdullahun. Më fal!

(Konsultime)

Fjalën e ka zoti Avdullah Hoti!

AVDULLAH HOTI: Të nderuar deputetë,
Pas konsultimit me kryesuesin dhe me shefin e Grupit “Vetëvendosje”, ne i propozojmë kryesuesit që sot të na ftojë në orën 12:00 në një konsultim shefat e grupeve parlamentare që janë përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës dhe pastaj deputetët e këtij Kuvendi njoftohen për kohën se kur caktohet seanca e ardhshme.

Unë ju ftoj që ta pranojmë këtë propozim të kryesuesit dhe të shkojmë në konsultime.

KRYESUESI: Do të thotë, u morëm vesh - po e ndërpresim seancën, e vazhdojmë kur të merren vesh grupet që bisedojnë. 61 deputetë janë në sallë.

O, Milaim urdhëro, por s’ke çka të thuash!

MILAIM ZEKA: Baca Adem!

Kështu, në radhë të parë, kam shumë respekt për ty dhe të kam dhëndër, dhe shprehja jote se ‘kam çka të them, e s’kam çka të them’ nuk të lejohet si kryesues i kësaj seance parlamentare.

Bëhu më serioz, sepse edhe dje ke bërë disa gabime, por t’i kam falur për shkak të moshës. Bëhu më serioz kur e udhëheq seancën dhe mos më detyro që ta bojkotoj këtë seancë dhe të mos bëhet këtu si odë, si ndonjë farë ode primitive, se është Parlament.

Edhe dje kam thënë para gazetarëve, “ata të cilët u vonuan dje, për kolegët e mi të partive të mia, kanë menduar që po vijnë në fushë të futbollit dhe jo në Parlament, për t’u bërë horë para korit diplomatik botëror dhe para qytetarëve të Kosovës”. Kjo është e para.

E dyta, i dashur Glauk, po të them si mik, si shok, mos e përdorni gjuhën e fushatës këtu dhe të paragjykoni formimin e Qeverisë, se me kë do ta bëni Qeverinë, a do ta bëni me LDK-në, a do ta bëni me minoritetet, sepse nuk ka kurrfarë marrëveshjesh paraprake. Sikur i bëj thirrje profesorit të nderuar, Avdullah Hoti, që të mos thotë që Kadri Veseli u dorëzua, sepse inatet ballkanike këtu janë shumë të mëdha dhe ai prej dorëzimit kalon në çdorëzim dhe thotë “hajde po e kallim Kosovën dhe nuk dorëzohem”.

Dhe, e fundit, ta ndërtojmë themelin, e themeli është ta krijojmë udhëheqësin e Parlamentit, ta zgjedhim kryetarin dhe Kryesinë.

KRYESUESI: Regjia, të lutem, ndërpritjani! Milaim, nuk ka debat, s’ka diskutim, të lutem!

Le të shkojmë ku të shkojmë, ti shko në vendin tënd, ne e vazhdojmë punën tonë. E hedh në votim, a pajtoheni me propozimin e Grupit Parlamentar “Vetëvendosje” për takim në orën 12:00 për caktimin e mbledhjes së ardhshme.

Nuk paska nevojë të votojmë, sepse më njoftuan që në sallë janë 59 deputetë. Do të thotë, informoheni me kohë për seancën e ardhshme. Mirupafshim!

* * *

E enjte, më 10 gusht

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 3 gusht

Mbledhjen e drejton deputeti i Kuvendit, z. Adem Mikullovc.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë!

Po e vazhdojmë seancën e Kuvendit që e kemi filluar më 3 gusht. Seanca konstitutive ka vazhduar punën më 4 gusht, por në mungesë të kuorumit është ndërprerë. Ju njoftoj së pari për vazhdimin e seancës konstitutive të Kuvendit, por të konstatojmë kuorumin, sa njerëz i kemi në sallë, kush po na mungon?

Kuorum nuk kemi. Në sallë janë 53 deputetë, propozoj ta bëjmë një pauzë të shkurtër prej 10 minutave, pastaj vazhdojmë.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton deputeti i Kuvendit, z. Adem Mikullovc.

KRYESUESI: I thërras deputetët që janë jashtë sallës të vijnë në seancë, sepse po na mungon kuorumi. Regjia, bjerini ziles, ju lutem!

Të nderuar deputetë, gjendja është kështu: kuorum të plotë nuk kemi, jemi 59 deputetë, por ajo kryesorja na mungon PAN-i dhe minoritetet në përgjithësi, kështu që jam i detyruar ta ndërpres punën e seancës, por më parë e thërras përfaqësuesin e “Vetëvendosjes” të dëgjojmë mendimin e tij.

GLAUK KONJUFCA: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Të nderuar mysafirë,

Të dashur gazetarë,

Janë bërë dy muaj faktikisht tash që prej mbajtjes së zgjedhjeve të 11 qershorit dhe u bë 1 javë prej kur ka filluar kjo seancë konstitutive, e cila nuk po mund të përfundojë.

Unë mendoj që është e pashembullt në historinë e parlamentarizmit në Evropë që ai që i thotë vetes fitues i zgjedhjeve dhe të cilëve, sipas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, u takon edhe propozimi që ta bëjnë për kryetarin e ardhshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës, vetë ata nuk vijnë në Kuvend dhe vetë ata nuk e japin propozimin për kryetarin e Kuvendit.

A thua, ku është problemi i PAN-it që nuk po vjen në seancë?! Nuk po u pëlqen rezultati i zgjedhjeve, nuk i kanë numrat për ta zgjedhur Kadri Veselin kryetar, nuk po duan assesit të dalin në opozitë, apo mos janë këto të tria së bashku. Ne i kemi parë vazhdimisht dy

qëndrimet e PAN-it, të cilat janë artikuluar në publik përgjatë këtyre dy muajve të fundit. Qëndrimi i parë, me të cilin na kanë lodhur duke na i përmendur, është që janë fituesit e zgjedhjeve dhe qëndrimi i dytë është se i kanë votat për ta zgjedhur kryetarin e Kuvendit. Nëse këto të dyja janë të vërteta, atëherë pse nuk e kemi Koalicionin PAN këtu në Kuvend? Pse po e bojkotojnë Kuvendin dhe pse po i mbajnë peng krijimin e institucioneve të Kosovës?

Dorën në zemër, këtë gjendje na e ka sjellë edhe një vendim i Gjykatës Kushtetuese, një aktgjykim, sipas të cilit zgjedhja e kryetarit të Kuvendit duhet të jetë prej anës së atyre që kanë fituar, atij subjekti ose atij koalicioni, i cili ka marrë numrin më të madh të votave në zgjedhjet parlamentare. Por, çështja duhet të shtrohet po ashtu në këtë kuptim: çka ndodh nëse atij, të cilit i takon ky propozim nuk vjen në Kuvend? Çka ndodh në këtë situatë? Sa mund të vazhdojë kjo gjendje? Duket që nuk ka asnjë rregull ku mund ta lexojmë, as në Rregulloren e Kuvendit, as në Kushtetutën e Republikës së Kosovës që një situatë e tillë nuk mund të vazhdojë pafundësisht. Por ata që pafundësisht po vazhdojnë kështu ta bojkotojnë Kuvendin e Republikës së Kosovës patjetër duhet ta marrin edhe përgjegjësinë morale, por edhe përgjegjësinë politike, pse po e mbajnë peng themelimin e institucioneve të Republikës së Kosovës.

Koalicioni PAN përgjatë gjithë javës së kaluar në mënyrë të paskrupullt, nëpërmjet zyrtarëve të vet e ka sulmuar kryesuesin e kësaj seance themeluese, një deputet të nderuar edhe të 2 korrikut, deputetin më të moshuar në mesin tonë, zotin Adem Mikullovc. Ne shprehim mospajtimin tonë dhe jemi shumë të indinjuar që ata në mënyra kaq të paskrupullta e sulmojnë deputetin Adem Mikullovc, duke u përpjekur që mbi një seancë konstitutive, mbi të cilin askush nuk ka monopol politik, ata po duan nëpërmjet disa takimeve konsultative të krijojnë njëfarë lloji të drejtës të vetos mbi këtë seancë themeluese të Kuvendit të Kosovës.

Askush nuk mund të ketë të drejtën e vetos mbi vazhdimin e kësaj seance. Ku ka qenë strategjia e PAN-it? Ku konsiston strategjia e tyre? Strategjia e tyre konsiston në qëllimin për të marrë sa më shumë kohë që t'ju qasen veç e veç deputetëve, të cilëve ata ua kanë mësyre për t'ua ndërruar qëndrimin e tyre politik, që t'i bindin që të votojnë për Kadri Veselin apo qoftë edhe për Qeverinë Haradinaj. Kjo është e papranueshme me standardet e demokracisë, kjo është shkelje e rëndë e demokracisë. Të mbahen peng institucionet për shkak të një emri dhe të blihet sa më shumë kohë që t'i takojnë deputetët e caktuar kafeneve që me presion dhe shantazh t'i bindin ata për ta votuar një kryetar të papëlqyeshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ne e dënojmë këtë praktikë, kjo praktikë nuk duhet të zërë vend në një shtet, i cili i thotë vetes “demokratik” dhe rregullimi i të cilit është një demokraci parlamentare, prandaj ne nga ky Kuvend i bëjmë tri thirrje: e para, angazhohemi të gjithë që jemi këtu, ne që jemi prezentë, e jo ata që nuk

kanë ardhur, për themelimin sa më të shpejtë të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Legjislaturën VI sipas rezultatit të zgjedhjeve të 11 qershorit.

E ftojmë PAN-in që ta ndërpresë bojkotin e seancës konstitutive dhe e ftojmë që ta propozojë kandidatin e tyre për kryetar të ardhshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Rregullat e demokracisë thonë kështu: kur nuk i ke votat dhe kur dëshiron t'i arrish ato, duhet të bësh kompromis. Kompromisin që ne po ua kërkojmë atyre është që të mos e qesin për kryetar të Kuvendit një figurë, e cila prej shumicës së deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës është e papranueshme. Nëse i pyesni të gjithë deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe Koalicionit LAA, ata thonë që Kadri Veseli nuk është i pranueshëm për kryetar të Kuvendit. Kjo i imponon Kuvendit të Kosovës zgjedhjen e një kryetari tjetër, nuk ka zgjidhje tjetër përpos zgjedhjes së një kryetari tjetër, përveç Kadri Veselit.

Dhe, nëse kjo ofrohet, atëherë ne do ta shqyrtojmë propozimin e tyre dhe të shkojmë përpara me themelimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Menjëherë pas kësaj presim që të vazhdohet me seancën për formimin e qeverisë së re, institucionet nuk mund të mbahen të bllokuara, shteti i Kosovës nuk ka kohë dhe para për të humbur.

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj përfaqësuesin e Koalicionit LAA për një fjalë rasti.

AVDULLAH HOTI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Përfaqësues të stafit diplomatik,

Media dhe qytetarë,

Është seanca e katërt që e mbajmë dhe nuk janë përfaqësuesit e koalicionit që udhëhiqet nga PDK-ja. Jemi 61 deputetë në sallë, me sa shoh tash, edhe me ardhjen e zotit Beqiri në sallë, pra ka kuorum për të vazhduar seancën në mënyrë të rregullt, ndërkohë që atyre që vendimi i gjykatës ua ka njohur të drejtën kushtetuese për të dhënë propozimin për kryetar të Kuvendit, nuk janë në sallë. Kjo e bën të qartë kush po e bllokon themelimin e institucioneve të vendit. Ne do të jemi konsistentë me qëndrimin tonë që të marrim pjesë gjithmonë në seancë, sa herë që seanca thirret në mënyrë të rregullt nga kryesuesi i seancës. Ne do të jemi gjithmonë të gatshëm të marrim pjesë në takimet konsultative që kryesuesi i seancës mund të ftojë në të ardhmen me të gjitha partitë politike që janë të përfaqësuara në Kuvend për t'u dakorduar për datën e seancës së ardhshme.

Ne jemi këtu, dëshirojmë të gjejmë zgjidhje, unë i ftoj deputetët e Koalicionit të PDK-së të jenë të arsyeshëm, vetëm njëri nga ta sot është prezent, të jenë të arsyeshëm, të jenë prezentë në seancë, të japin propozimin e tyre, të dëgjojnë vullnetin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe të lëvizim përpara në themelimin e institucioneve të vendit.

Kemi humbur shumë kohë, është dashur që edhe Kuvendi, edhe Qeveria të jenë funksionale për gati tash e dy muaj. Kjo e bën të qartë kush është i përgjegjshëm në themelimin e këtyre institucioneve.

Kryesues i seancës, unë sugjeroj që ju të ftoni takim tjetër konsultativ dhe të sigurohemi që t'i kemi të gjithë përfaqësuesit e partive politike në atë takim konsultativ dhe së bashku të merremi vesh për datën e seancës së ardhshme.

Përndryshe, ne duhet të konsiderojmë rrugë të tjera kushtetuese dhe ligjore për të bërë të mundur konstitutimin e institucioneve të vendit. Interpretimet juridike të juristëve tanë janë të qarta që një e drejtë kushtetuese mund të konsumohet edhe nëse nuk shfrytëzohet. Le ta kemi edhe një përpjekje të fundit për konstitutimin e institucioneve të vendit dhe të lëvizim në atë drejtim në rast se vazhdojnë që PDK-ja dhe koalicioni që udhëhiqet nga PDK-ja të bllokojnë themelimin e institucioneve të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kjo është seancë konstitutive, Arben, unë po ta jap fjalën, por nuk ka debat, s'është e paraparë që të ketë debat, të lutem. Prandaj, kërkoj falje, do të njoftoheni për vazhdimin e seancës së ardhshme. Vetëm t'ju njoftoj, në këtë moment kuorum kemi, por po mungon PAN-i dhe pa PAN-in s'mund ta vazhdojmë punën.

Në sallë janë të pranishëm 61 deputetë. Faleminderit dhe mirupafshim!

* * *

E hënë, më 14 gusht
Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 3 gusht
Mbledhjen e drejton deputeti i Kuvendit, z. Adem Mikullovc.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar të pranishëm,
Po e fillojmë vazhdimin e seancës, që e kemi filluar më 3 gusht të këtij muaji.

Në sallë janë 55 deputetë, që do të thotë nuk ka kuorum me këtë përbërje që e kemi këtu.

Gjithashtu na mungojnë deputetët e Koalicionit PAN dhe të minoriteteve.

Unë, sipas shpresës së zakonshme, nuk e di nëse kjo metodë është e mirë, prapë propozoj 15 minuta pushim - pauzë. Presim 15 minuta dhe e përfundojmë. Duhet t'i përmbahemi procedurës, ju lutem!

15 minuta pauzë dhe të shohim si po ia bëjmë më tutje, apo e mbyllim seancën.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton deputeti i Kuvendit, z. Adem Mikullovc.

KRYESUESI: Në sallë janë 53 deputetë,
Koalicioni PAN, siç po shihet, nuk ka ardhur. As minoritetet nuk kanë ardhur.

Kështu që nuk kemi kuorum. Megjithëse nuk kemi kuorum, unë kisha pasur dëshirë që pak të debatojmë, për këtë e thërras përfaqësuesin e partisë së dytë "Vetëvendosjes" që ta thotë mendimin e vet për situatën në të cilën gjendemi.

GLAUK KONJUFCA: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Mund të ju duket paradoksale ajo që do të them, por në të vërtetë këtë seancë ku ne po marrim pjesë, unë mendoj që e ka thirrur vetë PAN-i, i cili nuk po merr pjesë.

Më 24 korrik, presidenti Thaçi e thirri seancën themeluese të Kuvendit të Kosovës për t'u mbajtur më 3 gusht.

Kjo seancë pra, ku ndodhemi sot, është ajo e 3 gushtit, e cila po vazhdon dhe nuk po kryhet për shkak të bojkotit të Koalicionit PAN. E tash, nëse duan të bisedojmë se i kujt është Hashim Thaçi, i cili e ka caktuar këtë seancë, ku po marrim ne pjesë, besoj se nuk

kemi nevojë të përpiqemi fort gjatë për ta kuptuar, se ai është kryekëput në shërbim të Koalicionit PAN. Bile me disa takime që ai i zhvilloi javët e kaluara me disa eksponentë të PDK-së të sapoliruar nga burgu, na tregoi qartë se është dhënë me të gjitha forcat në funksion të krijimit të Qeverisë së ardhshme nga Koalicioni PAN.

Kjo i bie që Koalicioni PAN nuk po merr pjesë në seancën që e kanë thirrur ata vetë.

Me parametrat e logjikës, kjo i përmbush kushtet e një absurdi, por me standardet e politikës së PAN-it kjo strategji pa dyshim është tipike se si ata veprojnë dhe gjithmonë kanë vepruar politikisht.

Ata e interpretojnë të mirën e Kosovës nëpërmjet të mirës së tyre klanore.

Me këtë program ata e kanë keqqeverisur Kosovën në këto 18 vjetët e fundit.

Nëse po ju kujtohet mirë, në vitin 2014, PDK-ja e kishte kryesuesin e seancës dhe nuk thërriste seancë me qëllim.

Pra, ata e bojkotonin seancën në vitin 2014, duke mos thirrur seancë.

Dhe, themelimi i institucioneve, siç e dimë të gjithë, në atë kohë u vonua për gjashtë muaj, prej qershorit, kur u mbajtën zgjedhjet, deri në dhjetor të vitit 2014, kur u themelua Qeveria e Kosovës.

Por, sot, ata po e bojkotojnë themelimin e institucioneve, duke mos u shfaqur në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Atëherë duhet ta shtrojmë çështjen kështu: Ku e kanë hallin ata? Është shumë e thjeshtë. Nuk i kanë numrat as për ta zgjedhur kryeparlamentarin, as për ta themeluar Qeverinë e ardhshme të Republikës së Kosovës.

Po a thua pse ata nuk i kanë numrat? Sepse numrat e tyre i kanë në dorë qytetarët e Kosovës. Populli është zgjuar dhe me votën e vet do t'i zvogëlojë pa ndalë këto forca të mbrapshta që janë kundër qytetarëve, e të cilat punojnë vetëm për të mirën e tarafit, dhe jo për të mirën e shtetit.

Nëse e shikojmë pozicionin aktual të tri forcave politike më të mëdha këtu në Kuvend të Republikës së Kosovës, që është Koalicioni PAN, Lëvizja “Vetëvendosje” dhe Koalicioni LAA, atëherë është fare e qartë se Qeveria e ardhshme e Republikës së Kosovës është përpara dy alternativa: ose do t'i ketë 81 vota në krye me Lëvizjen “Vetëvendosje”, ose do t'i ketë 59 vota në krye me PDK-në. E tash as që dua të harxhoj kohë që ta shpjegoj se

cila Qeveri i duhet vendit tonë, sepse kjo duket sheshit dhe këtë e kupton çdo qytetar i Republikës sonë.

PAN-i deri tash është udhëhequr nga një logjikë totalitare dhe monopolizuese. Ata thonë kështu: Ose duhet të jemi ne në pushtet, ose nuk themelohen fare institucionet e Republikës. Kjo i bie që ata veten e vendosin në rend të parë, “ose ne ose hiç”, “ose ne, ose do të kolapsojë shteti i Kosovës”.

Edhe reagimi i këtyre ditëve i faktorëve ndërkombëtarë e ka bërë të qartë se për çka ka nevojë Kosova. Thirrja e QUINT-it që këtu të jenë të pranishëm ata që e kanë obligim ta paraqesin propozimin për kryetar të ardhshëm të Republikës së Kosovës tregon më së mirë se ku është defekti dhe ku ka ngecur shteti i Kosovës.

Pra, zgjidhja është shumë e thjeshtë: ata të cilët nuk po vijnë këtu duhet të shfaqen dhe ta japin propozimin e tyre. Të kenë guxim ta bëjnë këtë gjë.

Përndryshe, formulimi i një tjetër ambasade këtu në Kosovë se dikush nuk po guxon ta lëshojë pushtetin, sepse përfundon në bankat e drejtësisë, e tregon më së qarti se pse po vonohet krijimi i institucioneve të Kosovës dhe pse këta me çdo kusht duan të mbeten në pushtet. Kjo është arsyeja, sepse pushtetin e konceptojnë si amnisti nga drejtësia.

Unë mendoj që populli është kureshtar dhe shumë i etur për ta parë një ndryshim të qeverisjes në Kosovë, që krejt këto forca politike, të cilat tash po përfaqësohen nëpërmjet Koalicionit PAN të shkojnë në opozitë dhe ta shohin një qeverisje të re në Kosovë, sepse populli është mbi të gjitha i etur për ta marrë vesh keqpërdorimin masiv që ka ndodhur nëpër institucionet tona, sidomos në dimensionin e zhvatjes të parasë publike, që e ka bërë kjo qeverisje në Kosovë në këto 18 vjetët e fundit, por sidomos në 10 vjetët e fundit, që kur në Kosovë faktori kryesor i qeverisjes është bërë Partia Demokratike e Kosovës, në vitin 2007.

Sepse, mendoj që një qeverisje e ardhshme e cila nuk do ta kishte PDK-në si faktor vendimtar edhe si faktor i vendimmarrjes në Kosovë është shumë pozitive për Kosovën, sepse mendoj që ne të tjerët do t'i nxirrim në shesh të gjitha keqpërdorimet që kanë ndodhur deri më tash. Sepse nuk i kemi borxh askujt, përveç se borxhet që ua kemi qytetarëve për t'ua treguar të vërtetën e jetës institucionale në këto dy dekadat e fundit në Kosovë.

Dhe kemi shumë punë përpara. E kemi zhvillimin ekonomik që e pret Kosovën, reforma në drejtësi, që nuk kanë ndodhur kurrë dhe që Kosovës t'ia sjellim një situatë kur nuk do

të kemi më raporte të progresit që na vijnë në Kosovë dhe thonë që administrata është totalisht e politizuar dhe gjyqësori totalisht i kapur.

Nëse PAN-i nuk ka kandidat tjetër përveç Kadri Veselit, ta zëmë si supozim, atëherë ne i ftojmë ata - nëse nuk kanë propozim tjetër, të vijnë dhe ta hedhin këtë propozim në votim. Ne jemi të gatshëm të marrim pjesë në votim. Le ta vënë Kadri Veselin, nëse është më i duhuri dhe nëse nuk kanë kandidat tjetër. Por, nëse kanë kandidat tjetër, atëherë le ta ndërrojnë sa më shpejt dhe të mos e mbajnë peng krijimin e institucioneve të Kosovës dhe themelimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ne me këtë rast propozojmë që kjo seancë t'ua zërë vendin tryezave politike që po i kërkon PDK-ja.

Ne mendojmë që është më mirë që debati të zhvillohet aty ku e ka vendin, në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe në seancë. Jo në disa tryeza joformale, e bile edhe të paligjshme që po i kërkon PAN-i, në mënyrë që ta zëvendësojë këtë seancë me debate politike, ku ne tash aty i shprehim vizionet tona për Kosovën se kush do të jetë kryeministër i ardhshëm, se a do ta votojmë ne apo jo Ramush Haradinaj për kryeministër, dhe ta shndërrojmë këtë seancë konstituive në tryeza të debatit të pafundmë politik. Kjo është e gabueshme dhe kjo është arsyeja pse "Vetëvendosje" i kundërshton ato konsulta, të cilat po i thërret PAN-i dhe të cilat janë vetëm me një qëllim - për të blerë kohë pafundësisht derisa ata i kryejnë pazaret e tyre të pista individualisht me ndonjë deputet skutave apo kafeneve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, ju lutem!

GLAUK KONJUFCA: Për këtë arsye, ne ftojmë që kjo seancë e sotme të vendosë që të zhvillojmë debat politik këtu dhe secili prej nesh ta ketë të drejtën të flasë, ta shprehë mendimin e vet për situatën e krijuar, se cilat janë zgjidhjet më të mira, të shërbejë kjo seancë edhe si thirrje për PAN-në që të marrë pjesë në seancë dhe, tek e fundit, ne e kemi bërë betimin para disa ditësh si deputetë të këtij Kuvendi. Ne kemi të drejtë të flasim në këtë Kuvend. Sa kam të drejtë unë të flas, edhe Avdullah Hoti, keni po aq të drejtë secili nga ju. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj përfaqësuesin e Koalicionit LAA, le të urdhërojë ta marrë fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Përfaqësues të medieeve,

Të nderuar qytetarë,

Përfaqësues të stafit diplomatik këtu në këtë seancë,

Është seanca e pestë me radhë që ne mbledhemi në Kuvendin e Republikës së Kosovës për t'i konsistuar institucionet e vendit në bazë të Kushtetutës dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Është për keqardhje dhe është fyerje për qytetarët e vendit që deputetët e zgjedhur nuk marrin pjesë në seancë të thirrur në mënyrë të rregullt nga kryesuesi i seancës.

Mendoj që tanimë është e qartë për të gjithë pa përjashtim se kush janë bllokuesit e formimit të institucioneve të vendit. Është koalicioni i udhëhequr nga PDK dhe mua më vjen keq që edhe përfaqësuesit e minoriteteve nuk janë sot të pranishëm, dhe i bashkëngjiten atij koalicioni.

Më lejoni në këtë rast, në emër të koalicionit tanë, ta përshëndes deklaratën e ambasadorëve të QUINT-it, të cilët qartë i ftojnë deputetët ta kryejnë obligimin kushtetues që të jenë në seancën e Kuvendit dhe të procedojnë sipas Kushtetutës në themelimin e institucioneve të vendit.

Kjo situatë nuk mund të vazhdojë më tutje. Ne si koalicion jemi duke i shqyrtuar modalitetet dhe hapat kushtetues që duhet të ndërmerim për t'i themeluar institucionet e vendit.

Në seancën e kaluar, unë para jush e kam bërë të qartë që jemi duke punuar brenda grupit tonë parlamentar në sqarimin e bazë juridike për dy pyetje që duhet t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

E para, që me mospjesëmarrjen në seancë dhe mosprezantimin e kandidatit për kryetar të Kuvendit konsumohet e drejta kushtetuese për ta pasur kryetarin e Kuvendit, dhe

E dyta, çka ndodh me rastin në rast kur një kandidat që propozohet për kryetar të Kuvendit nuk e merr mbështetjen e nevojshme.

Këto janë dy pyetje që duhet t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

Grupi ynë parlamentar është duke punuar në organizimin e një debati, një tryeze të partive politike të LDK-së, AKR-së dhe Alternativës brenda grupit tonë parlamentar. Do

të ftojme “Vetëvendosjen” dhe të gjitha minoritetet që të ulemi bashkë sa më shpejt që është e mundshme për ta sqaruar bazën juridike për këto dy pyetje dhe për t’u dakorduar pra aq sa është e mundshme për ndërmarrjen e hapave konkretë drejt zhblokimit të themelimit të institucioneve të vendit.

Jemi duke e finalizuar një listë edhe të ekspertëve e të shoqërisë civile dhe të fushës akademike që do të na ndihmojnë në draftimin e këtyre pyetjeve dhe ajo që është e nevojshme është ndërtimi i konsensusit ndërmjet deputetëve këtu që janë në sallë në mes të dy grupeve parlamentare këtu në sallë për hapat konkretë që duhet t’i ndërmarrin.

Tani më situata është e qartë se kush e bllokoi themelimin e institucioneve të vendit. Është e qartë Kushtetuta dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, pavarësisht që nuk pajtohemi sa të drejta janë ato vendime.

Unë në emër të grupit tonë parlamentar do ta ftoj këtë tryezë në ditët e ardhshme, do të merrni ftesë zyrtare edhe ju si “Vetëvendosje” dhe gjithashtu minoritetet për t’u ulur dhe për t’i draftuar pyetjet për Gjykatën Kushtetuese. Rrugë tjetër nuk ka. Është hera e pestë që në mënyrë të rregullt ftohet seanca nga kryesuesi i seancës. Ne marrim pjesë këtu, kemi mbështetjen e faktorit ndërkombëtar për të gjithë deputetët që të marrin pjesë në seancë dhe ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre kushtetuese.

Kryesues i kësaj seance, ashtu si e kam thënë edhe herën e kaluar, unë ju ftoj që të thirrni në takim konsultues, si Lidhje Demokratike si koalicion gjithmonë kemi qenë pro dialogut dhe gjetjes së zgjidhjes. Edhe tryeza që sa e propozova është në frymën e krijimit të dialogut të nevojshëm brenda institucioneve të vendit, në mënyrë që në seancën e radhës përfundimisht t’i japim zgjidhje krijimit të institucioneve të vendit.

Unë ju ftoj që ju në ditët e ardhshme ta ftoni takimin konsultues me të vetmin pikë të rendit të ditës, që është caktimi i seancës së ardhshme.

Në ndërkohë, ne do ta organizojmë tryezën tonë për t’i bërë gati argumentet juridike për t’iu drejtua Gjykatës Kushtetuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A ka edhe dikush tjetër të thotë mendim për këtë? Unë, thënë të drejtën, po mendoj, meqenëse PAN-i me këmbëngulje nuk dëshiron të vijë në mbledhje derisa të mbahet edhe një bisedë konsultative me të gjitha partitë që janë deputetë të Kuvendit.

Këtu shihet qartë që “Vetëvendosje” nuk është për një takim të tillë, për një konsultim të tillë, se e ka mendimin që konsultime të tilla mund të bëhen vetëm këtu në Kuvend, do të vijnë në Kuvend.

Unë marr të drejtën time dhe e them, ju propozoj që, megjithatë, ata kanë kërkuar ta caktoj edhe një bisedë konsultative me ta, unë do të shkoj me ta. “Vetëvendosje” dhe Koalicioni LAA, vijnë a nuk vijnë, është punë për ta a marrin pjesë apo jo, por do të shkoj në takim të mërkurën, në orën 10:00, vetëm me një pikë të rendit të ditës, kur janë të gatshëm të vijnë në seancat e Kuvendit dhe të dalin me emrin e kandidatit për kryetar të Kuvendit. Kjo është hera e fundit. Nëse, sikur konsultimet tjera, se pas konsultimit të parë menjëherë kërkuan një konsultim pas disa ditësh. E pranova, e caktova atë takim, u takuam, dhe menjëherë kërkuan edhe një takim tjetër pas disa ditësh. Vazhdimisht zvarritje e punës. Këtë nuk do ta pranoj kurrësi. Por, do të takohem me ta të mërkurën, do t’i dëgjoj dhe fund do t’ua bëj pyetjen, atë që po e bëjmë të gjithë ne këtu, kur do të vini në mbledhje, kur jeni të gatshëm të dilni me emrin e kandidatit për kryetar të Kuvendit? Më tepër s’kam çka të flasë me ta. Urdhëroni!

Urdhëro, zoti Sami Kurteshi, deputet i “Vetëvendosjes”, e ke fjalën.

SAMI KURTESHI: I nderuar kryesues,

Të nderuar dhe të nderuara kolege deputete,

Të nderuar mysafirë,

Neni 58 i Kushtetutës së Kosovës, paragrafi 7 thotë: “Republika e Kosovës siguron në baza jodiskriminuese që të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre të mund t’i ushtrojnë të drejtat e tyre të specifikuara me këtë Kushtetutë”.

Neni 21 i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në paragrafin 2 thotë shprehimisht: “Deputeti i Kuvendit të Kosovës ka të drejta dhe detyra të barabarta për pjesëmarrje të plotë në punimet e Kuvendit dhe vepron sipas bindjes dhe ndërgjegjes së tij”. E theksoj “të drejta dhe detyra të barabarta për pjesëmarrje të plotë në punimet e Kuvendit”.

Përfaqësuesit e komuniteteve, ashtu siç quhen joshumicë, apo pakicave, apo minoriteteve, nuk duhet të udhëhiqen nga “parime” kundërkushtetuese, kundërligjore dhe t’i bojkotojnë punimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Pa marrë parasysh përbërjen e Kuvendit, apo të Qeverisë, përfaqësuesit e komuniteteve, si përfaqësues të njerëzve të tyre me vende të garantuara në këtë Kuvend, për shkak të votës së kërkuar dhe të marrë, për të qenë pjesë e këtij Kuvendi, ku diskutohen dhe përfaqësojnë interesat edhe të komuniteteve të tyre, janë të obliguar dhe duhet të jenë të

pranishëm në seancat e Kuvendit. Deputetët e komuniteteve joshumicë formalisht nuk janë pjesë e Koalicionit PAN, mirëpo asnjëherë nuk i kanë sqaruar qëndrimet e tyre.

Pyetja ime për të gjithë deputetët dhe deputetet e komuniteteve joshumicë është: Pse bojkotoni punimet e Kuvendit? Cila është arsyeja? Interesi i komuniteteve të tyre, interesi shoqëror është që komunitetet gjithmonë të jenë të pranishme në vendet që u garanton Kushtetuta për të mbrojtur dhe përfaqësuar interesin e komuniteteve të tyre. Cila është arsyeja që ata, pa asnjë sqarim, nuk bëhen pjesë e institucioneve që kanë të bëjnë me interesat e komuniteteve të tyre, apo ndoshta udhëhiqen nga interesa personale, mirëpo për këtë nuk e kanë marrë votën.

Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! Ka edhe dikush që dëshiron fjalën? Urdhëroni, zonja Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Është hera e parë që po drejtohem nga kjo foltore si deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe, në herën e parë, në adresimin tim publikisht u kërkoj falje qytetarëve të Republikës së Kosovës për situatën, e cila është krijuar në vend, për përgjegjësinë që secili nga ne e mbajmë dhe sot asnjëri nga ne për arsyet, të cilat tashmë po dihen, nuk mund të jemi në krye të kësaj përgjegjësie për shkak se në vend, se në këtë Kuvend të bëjmë zgjidhje për problemet e qytetarëve të Republikës së Kosovës, po i rëndojmë qytetarët e Republikës me problemet që po

u shkaktojmë ne nga ky Kuvend, ne, po flas si deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Situata e krijuar vetëm ka filluar të shkaktojë humbje, të cilat sot edhe kanë edhe shifra dhe vlera monetare. 15 milionë euro të kredisë së Fondit Monetar Ndërkombëtar u humbën si rrjedhojë e faktit që s'kemi pasur Qeveri, e cila do të ishte në përbërje dhe funksionalitet të plotë për të nënshkruar këtë kredi. 5 milionë euro u shpenzuan për mbajtje të zgjedhje të jashtëzakonshme. Ekziston rreziku i mbajtjes së zgjedhjeve të tjera të jashtëzakonshme, ku zgjedhjet e jashtëzakonshme bëhen situatë e zakonshme në vendin tonë, atëherë me të vërtetë jemi duke ia ofruar një shteti me një status të krizës së përhershme.

Ajo çka ne po ballafaqohemi tash është me kërkesë për konsultime të mëtutjeshme të partisë ose koalicionit, i cili doli i pari nga këto zgjedhje. Konsultimet është dashur të bëhen para mbajtjes së zgjedhjeve, konsultimi i vetëm që mund të mbahet tash është caktimi i seancës kur do të përmbillet seanca e parë e Kuvendit të Republikës së Kosovës

në Legjislaturën VI, ku Kuvendi t'i zgjidhë organet e veta dhe të mandatohet një përfaqësues i këtij koalicioni për formimin e qeverisë dhe të fillojë ecja e 15-ditëshit, brenda së cilit ata duhet të formojnë apo të mos e formojnë Qeverinë. Por, jo të vazhdojmë dhe të thellojmë krizën e krijuar në Kosovë, e cila është duke u vënë mbi supet e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Të mos harrojmë edhe një fakt, këtë vit prapë njëjtë, sikurse në vitin 2014, Kosova do të mbesë pa rishikim të buxhetit. Kjo mungesë e rishikimit të gjitha agjencive buxhetore do t'u shkaktojë probleme shumë të mëdha. Në ato probleme do të ketë fatura të papaguara, do të ketë mungesë të realizimit të projekteve, do të ketë drejtpërdrejt humbje të gjitha agjencitë buxhetore dhe, rrjedhimisht të mungesa e performansës së institucioneve. Ajo çka më duhet të them edhe njëherë është gjithashtu t'i kërkoj falje korit diplomatik të Kosovës dhe atyre që janë përfaqësues të akredituar këtu dhe jashtë që e përcjellin me brengosje situatën në një vend që besuan shumica prej tyre se do të jetë demokraci funksionale.

Por, gjithashtu është edhe një mesazh pozitiv apo një dritë në fund të tunelit, se ky është fillimi i fundit i një keqqeverisje, i një mentaliteti që shtetin mund ta trajtojmë si plaçkë tonën. Shteti nuk trajtohet si plaçkë dhe se nuk mund të bëhet një gjë e tillë, po shihet në karriget e zbrazëta këtu para meje dhe para jush, dhe para të gjithë qytetarëve të Kosovës, se ata gradualisht kanë filluar të heqin dorë nga ato gjëra që i kanë kapur, e fatkeqësisht një kapje e tillë më e rënduar është edhe tek organet e rendit, tek organet e drejtësisë, tek një vendim i gabuar i Gjykatës në vitin 2014 që e favorizoi një grup politik, por që ai vendim tash po i vjen mbrapa dhe po e han po të njëjtin grup politik. Prandaj, për të gjithë ne këtu ta kemi një të përbashkët që së bashku të dakordohemi që të ketë një takim të subjekteve politike për caktimin e datës kur do të përmyllet krijimi i institucioneve, gjegjësisht konstitutimi i Kuvendit dhe pas saj të fillojë 15-ditëshi, se moskonstitutimi i Kuvendit nuk është duke e bërë një zgjidhje për Kosovën, por është duke e thelluar krizën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Frashër Krasniqi e ka kërkuar fjalën.

FRASHËR KRASNIQI: I nderuar kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Është shumë interesant të vish për herë të parë në Kuvend edhe të shohësh që koalicioni i krimt, që ia mbajnë vetit për të guximshëm, për komandantë, nuk guxojnë të vijnë dhe të jenë të pranishëm këtu në këtë sallë. Kjo është ndjenjë e mirë për fillim, mirëpo është keq që nuk po krijohen institucionet e Kosovës.

Është interesant për shkak se Ramush Haradinaj thoshte që merret vetëm me sporte të rënda, është shumë çudi qysh është duke u fshehur gjatë gjithë kohës, prej që ka filluar ky Kuvend, ndërkohë po ashtu edhe Kadri Veseli, i cili ende nuk po mund ta pranojë dështimin e madh që e ka pësuar në fushatë, ka humbur krejt, nuk po duket kurrkund, është fshehur, përveç kur po e nxjerr PDK-në t'i prishë parqet në komunë të Prishtinës për t'ia lënë fajin "Vetëvendosjes", për të thënë se "po keqqeverisin".

Mirëpo, kjo sa për fillim është shenjë e mirë, sepse tregon që edhe nëse këta arrijnë t'i bëjnë numrat dhe ta bëjnë njëfarë qeverie, diqysh me shantazhe, me kërcënime, me joshje, kjo do të jetë qeveri e ikjes, do të jetë qeveri e panikut, ashtu qysh po fillon ky mandat, me ikjen e tyre. Dhe, kjo maksimalisht do t'i ketë 1 deri 2 vjet jetëgjatësi dhe do të jetë shënjeshtër i fundit i përfundimit të qeverisjes së krimit, i përfundimit të qeverisjes së kriminelëve që nuk kanë lënë asgjë pa bërë në Kosovë, të gjitha të këqijat i kanë bërë, duke u thirrur vazhdimisht në emër të luftës dhe komandantllëkut. E kanë shkatërruar ekonominë, e kanë falur territorin, kanë qenë në gjendje për ta kthyer Serbinë në Kosovë, krejt këto dhe prapë në fund të thonë se 'ne jemi komandantë, ne jemi krah i luftës'. E që ku po duan ta bazojnë krijimin e qeverisë të re që ende nuk po mund ta bëjnë, por që janë duke shpresuar ta bëjnë: në dy shtylla kryesore: në Listën Serbe, më saktësisht, kriminelin Milan Radojeviq, që është zëvendës i Veselinoviqit, që ka kryer edhe vazhdon të kryejë krime në veri të Kosovës, që i kërcënon me vdekje policët e Republikës së Kosovës dhe me të cilin Ramush Haradinaj po takohet vazhdimisht për t'ia marrë mbështetjen e Listës serbe, si dhe shtylla e dytë, po pritet të jetë Ukë Rugova, një kriminel tjetër ordiner për bëmat e të cilit i dimë tashmë të gjithë.

Pra, ja çfarë krahu i luftës e çfarë trima e të guximshëm janë këta! Për ta ruajtur krimin e tyre edhe nja 2 vjet maksimumi, janë në gjendje t'i bien në gjunjë Listës Serbe, janë në gjendje t'i bien në gjunjë Ukë Rugovës, e ne e dimë çka kanë folur këta tërë jetën e tyre për Ibrahim Rugovën. Janë në gjendje që t'i bien në gjunjë Ukë Rugovës dhe kriminelëve të tjerë sikur ai e sekserëve të tjerë që tërë kohën kanë qenë të parëndësishëm, kurse sot po bëhen përcaktues për institucionet e vendit.

KRYESUESI: Më fal, të lutem, mos dil prej teme, përmbajuni temës që e kemi.

FRASHËR KRASNIQI: Jo më larg, po veç po mundohem të flas pak për arsyet çka është duke ndodhur në situatën politike, çka është duke u zhvilluar, në fakt, brenda vetë PAN-it, çka po e pret Kosovën edhe kur të vijnë ata këtu në këtë seancë. Jo më larg se më 25 shkurt të këtij viti Pal Lekaj vetë pati deklaruar që Lista Serbe "është një grup banditësh", po e citoj "pinjollë të Nikoliqit, Vuçiqit dhe të Daçiqit" dhe kishte kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të shpallen persona "non grata" dhe të përjashtohen komplet nga Republika e Kosovës". Çka ka ndryshuar tash?

Tash, ju po e shihni, janë bashkë me Listën serbe, nuk vijnë në Kuvend, por koordinohen qind për qind me ta, e cila po ashtu i thoshte Ramush Haradinaj “kriminel i luftës”, por tash nuk kanë më problem që të bashkëpunojnë, sepse është e qartë që Ramush Haradinaj, Kadri Veseli për të vazhduar qeverisjen e tyre janë të gatshëm të harrojnë gjithçka çka kanë folur, janë të gatshëm ta kthejnë ndikimin e Serbisë dhe këtë po e di Lista Serbe, prandaj nuk po i pengon Ramush Haradinaj. Por, çka nuk po kupton në naivitetin e tij politik Ramush Haradinaj është që edhe nëse arrin t’i shantazhojë disa deputetë, t’i kërcënojnë dhe t’i blejnë, se ashtu po duket, edhe nëse arrijnë ta bëjnë këtë punë, populli i Kosovës e ka bërë ndryshimin, është përcaktuar gjithçka. Ramush Haradinaj për t’u bërë kapiten ka hipur në një barkë, e cila është duke u fundosur, të cilës i ka ardhur fundi dhe këtë fund kemi për t’ia siguruar në momentin që kthehen në Kuvend, nuk kanë për të pasur qeverisje të rehatshme për asnjë moment gjatë kësaj legjislature. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj Drita Millakun dhe le të bëhet gati Labinot Tahiri. Ftoj deputetët që marrin pjesë në debat, në diskutim, t’i përmbahemi këtij problemi, si të dalim nga ky ngërç, kur po na mungon PAN-i? Urdhëroni, zonjë!

DRITA MILLAKU: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje të gjithë të nderuar,

Përshëndetje për të gjithë qytetarët që janë duke na përcjellë,

Katër herë radhazi jemi ftuar sot, është hera e pestë që po ftohemi për t’i konsoliduar institucionet, ne deputetët të cilët na zgjodhi populli. Edhe pse kisha probleme shëndetësore, konsiderova që përpara qytetarëve ky angazhim është më i domosdoshëm dhe e pashë të arsyeshme të jem, jo vetëm ta jap betimin, por sa herë të na ftojë kryesuesi, të qëndroj dhe të jem këtu.

Të gatshëm nuk ishin të gjithë dhe nuk janë, ata të cilët po thirren se i kanë marrë votat dhe kanë dalë të parët, është fjala për PAN-in. E pakuptimtë është pengesa e tyre për zvarritjen e formimit të institucioneve dhe kjo vjen si rezultat i mungesës së numrave se po t’i kishin numrat, ata këtu do të ishin para nesh sot. Vij nga qyteti i Prizrenit, një ish-bastion i PDK-së dhe i SHIK-ut deri më datën 11 qershor dhe e di shumë mirë se si i kanë marrë votat ata me shantazhe, me kërcënime dhe me blerje. Kësaj here duam ta arsyetojmë PAN-in pse nuk po e lëshon mundësinë të jetë në Qeveri.

Dua t’i përmendi vetëm tri pika të programit të Lëvizjes “Vetëvendosje” që i kam shumë për zemër dhe që do të jem kujdestare e pakompromis deri në realizimin e këtyre pikave:

1. Pika 31 e programit të qeverisjes së Lëvizjes “Vetëvendosje” ka të bëjë me hetimin parlamentar të organizatës së SHIK-ut.

2. Pika 33 është zbardhja e vdekjes së Astrit Deharit dhe të gjitha vrasjeve të pasluftës, duke përfshirë edhe vrasjen e Komandant Drinit.

3. Pika 35, miratimi dhe zbatimi i Ligjit antimafia.

Jam e bindur që me zbatimin e këtyre tri pikave, një pjesë shumë e madhe e deputetëve dhe e politikanëve të PAN-it do të përfundojë në burgje. Po, është e vërtetë dhe shpëtim nuk ka, veç se ka vonim. Pra, kjo është arsyeja kryesore që ata me çdo kusht insistojnë të mbesin në qeveri dhe, për fund, të gjithë ata, të cilët iu kanë bashkangjitur PAN-it dhe mendojnë t'i bashkëngjiten ose janë profiterë të luftës, ose janë vrasës të pasluftës apo haraqexhinj e biznesmenë që shpëlajnë para, se ndryshe nuk do të kishte mundësi të ishin bashkë. Domethënë këta interesi i ka ndarë, ndërsa tani së fundi frika i ka bërë bashkë.

Më 11 qershor e kanë marrë 'nogdaunin' klasik dhe jam e bindur që më 22 tetor do t'i qesim të gjithë nga ringu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Le të urdhërojë zoti Labinot Tahiri, le të bëhet gati Fatmire Mulhaxha.

LABINOT TAHIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju që jeni që 18 vjet në këtë Parlament, unë vetëm i drejtohem popullit se nuk kam ardhur këtu në Parlament dhe nuk kam marrë vota për të krijuar një urrejtje mes nesh. Unë mendoj që gjuha parlamentare është ndryshe. E falënderoj shumë zotin Behgjet Pacolli, me gjithë insistimin e tij për kandidimin tim si deputet dhe me dekorim të numrit 10, unë tani jam këtu një shërbëtor i popullit.

Më duhet t'i drejtohem kolegut deputet, zotit Krasniqi, që komandantët kanë gjithmonë guxim, e dini ju mirë dhe e dimë të gjithë ne këtu, edhe po të mos ishin ata komandantë as zoti Adem Mikullovcu nuk do të ta kishte përjetuar prapë gjuhën shqipe ta flasë këtu në Parlament, kur dikur e ka dëbuar me dhunë Serbia. Unë them, mos i përfshij të gjithë njerëzit, sepse ka njerëz të ndershëm edhe prej komandantëve. Ata që janë nëpër gjykata sigurisht një ditë ndoshta do t'u ndodhë të gjykohen, por unë këtu mendoj që duhet tjetër gjuhë që të ecim përpara. Nuk më intereson e kaluara, nëse duam të ecim përpara dhe t'i zhbllokojmë institucionet, duhet me gjuhë të jourrejtjes, por mendoj që bashkim politik për të ardhmen e këtij vendi. Është e rëndë para këtyre diplomatëve që t'i fyesh të gjithë komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Respekt!

KRYESUESI: Faleminderit! Le të urdhërojë Fatmire Mulhaxha, bëhet gati Arben Gashi.

FATMIRE MULHAXHA: I nderuar kryesues!

Kolegë deputetë,

Përfaqësues të medieve dhe ju mysafirë,

Deputeti i zgjedhur ka përgjegjësi dhe obligime, dhe unë mendoj që assesi nuk mund të barazohen deputetët prezentë sot këtu në këtë seancë me ata deputetë që sot qëndrojnë diku tjetër dhe nuk janë në nivel të detyrës për çka janë zgjedhur.

Ju e dini fare mirë dhe krejt opinionin publik që seancën e ka thirrur ai i cili do të duhej të përfaqësonte unitetin e popullit, do të thotë presidenti i vendit. Duke na siguruar neve dhe tërë qytetarët e Republikës se përfaqësuesit e Koalicionit PAN e kanë siguruar, që i kanë votat e nevojshme, prandaj është thirrur seanca më 3 gusht, ju e dini me shumë vonesë vetëm 5 ditë para përfundimit të afatit ligjor. Dhe, çfarë ndodhi? Ndodhi që përfaqësuesit e PAN-it jo vetëm që erdhën me vonesë, por me një arrogancë të paparë erdhën dhe e treguan që ajo nuk ishte e vërtetë. Dhe, çka ndodhi? Prapë ai që do të duhej të përfaqësonte unitetin e popullit nuk doli, i pati dy obligime: ose t'i ftojë përfaqësuesit e PAN-it në një takim publik dhe ta sqarojë situatën apo të dalë dhe të kërkojë falje publike para qytetarëve të Republikës, pse ndodhi ajo çfarë pamë ne këtu?! Dhe, pse po ndodh në vazhdimësi deri në ditën e sodit kjo.

Ju e dini që vetëm një zgjidhje është, të gjitha takimet konsultative është dashur të përfundojnë deri më 3 gusht. Ne që jemi këtu nuk kemi çka të konsultohemi, të gjithë ne jemi deklaruar publikisht që nuk do të bëjmë koalicion me të ashtuquajturin “Koalicion PAN” dhe besoj që kjo nuk do të ndryshojë. Ata erdhën, kërkuan kohë. Ju lutem, nuk kërkuan kohë për 2 deputetë eventualisht nga koalicioni i tyre, që për ndonjë arsye do të ishin jashtë shtetit dhe t'i presim ne me mirëkuptim që të kthehen në vend, plus nuk na siguruan që janë në bisedime për një koalicion tjetër të mundshëm. Ajo çfarë kërkuan është që qoftë me shantazhe apo me joshje t'i përfitojnë edhe dy vota në favor të tyre nëpërmjet dy deputetëve që përfaqësuesit e tyre janë deklaruar publikisht që nuk do të bëjnë koalicion me PAN-in, që do të thotë vetëm kontrabandim, ose vullneti i atyre deputetëve i ndryshuar brenda natës dhe të ndodhë diçka e re. Dhe, ajo nuk po ndodh, se unë besoj në integritetin e çdo deputeti, atë që e deklaroi publikisht, ai duhet të qëndrojë prapa saj.

Prandaj, faktikisht nuk po shihet që i kanë numrat. Përgjegjësia e tyre është që të vijnë këtu, të deklarohen, ta qesin kandidatin fillimisht për kryeparlamentar, nëse votohet mirë, nëse jo, kanë mundësi që ta ndryshojnë kandidatin dhe të hapin rrugë për krijimin e institucioneve. Përndryshe, qytetarët e Republikës kanë rastin të shohin kush sot ia do të mirë këtij vendi, pa marrë parasysh çfarë të kaluarë e ka cilido prej nesh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Arben Gashi e ka fjalën, le të bëhet gati Arbër Rexhaj.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne sot këtu në këtë sallë duhet të dërgojmë mesazhe të qarta të përfaqësimit qytetar, të vlerave njerëzore dhe idealit të shoqërisë kosovare. Duhet të dërgojmë mesazhe se çfarë shoqërie po ndërtojmë dhe cila do të jetë e ardhmja për qytetarët e Kosovës dhe cila do të jetë e ardhmja për fëmijët tanë.

Gjuha e cila përdorim ne duhet të jetë e kujdesshme dhe jo një gjuhë e cila na çon në konflikte të brendshme të panevojshme. Po ashtu, elementi kryesor, të cilin ne e kemi, që na bashkon të gjithëve këtu është të qenit deputet, përfaqësues të popullit, të cilët duhet të mbledhen në Kuvendin ku përfaqësojnë popullin dhe si rezultat i dialogut, diskutimeve, debateve, gjejnë zgjidhje. Zotërinjtë e Koalicionit PAN, të cilët nuk vijnë që pesë seanca në Kuvend, kanë humbur esencën. Ata janë për të përfaqësuar elektoratin e tyre në Kuvend, për të ardhur në Kuvend dhe për të diskutuar, për të gjetur zgjidhje, për të dhënë propozime. Ata e kanë të drejtën ekskluzive të propozimit të kandidatit apo kandidatës për kryetare të Kuvendit, por nuk e kanë të drejtën ekskluzive të bllokimit të punës së Kuvendit. Ata duhet të propozojnë, ata ende nuk kanë propozuar.

U bënë disa muaj që zgjedhjet kanë përfunduar dhe ata nuk kanë ardhur në Kuvend që të propozojnë një kandidat apo kandidatë, për të cilën ne me votën tonë duhet të vendosim. Sepse ndoshta mund të jetë ndonjë kandidat apo kandidatë që ata e propozojnë dhe që është i pranueshëm për të gjithë ne ose për disa, të paktën për 61 prej nesh. Dhe në këto rrethana ne duhet të shohim se jemi në dy situata: situata e parë është e bllokadës politike si rezultat i refuzimit të vazhdueshëm të Koalicionit PAN për të marrë pjesë në seanca dhe propozuar kandidatin e tyre. Dhe, situata e dytë është kushtetuese: si duhet të dalim prej kësaj gjendje ne? Ne duhet të gjejmë një zgjidhje, nëse ata nuk janë të gatshëm të vijnë në Kuvendin e Kosovës dhe të propozojnë kandidatin e tyre, atëherë ne duhet të shohim se cila është rruga e daljes. Rrugë e daljes, për mendimin tim personal, do të duhej të konsiderohej edhe mundësia e procedimit të Kuvendit me vetëdije, me zgjedhjen e nënkryetarëve dhe trupave të tjerë, ata që na takojnë.

Neve na takojnë, “Vetëvendosjes” i takon një nënkryetar, Lidhjes Demokratike i takon një nënkryetar, komunitetit serb i takon një nënkryetar dhe komuniteteve tjera u takon një nënkryetar, sepse ju e dini se Kryesia e Kuvendit është organ politik, sipas organizimit kushtetues që e kemi në Kosovë. Kryetari i Kuvendit është përfaqësuesi i grupit më të madh politik, por Kryesia si e tillë është përbërje politike, nuk është përbërje menaxheriale. Kur është konceptuar Kushtetuta e Kosovës, në esencën e vetë e ka pasur përbërjen e kryesisë së Kuvendit, si organizim politik, si përfaqësim edhe etnik, edhe i forcave politike në Kuvend. Pra, PAN-i e ka kryetarin dhe nënkryetarin e parë,

“Vetëvendosja” e ka nënkryetarin e dytë, LDK-ja nënkryetarin e tretë, komuniteti serb nënkryetarin për pakicën serbe dhe komunitetet e tjera e kanë një nënkryetar me rotacion.

Pra, tërësia e tij është një përbërje politike. Askush dhe asnjë praktikë nuk mund të na mohojë neve të drejtën e propozimit të kandidatëve tonë, me rëndësi është që ne të mobilizohemi, të jemi të paktën 61 deputetë në sallë dhe të propozojmë kandidatët tonë, të zgjedhim kandidatët dhe nëse arrijmë t’i bindim edhe komunitetin serb edhe komunitetet e tjera që të vijmë në seancë dhe ata t’i propozojnë përfaqësuesit e tyre, atëherë ne kemi kuorum për punë dhe hyjmë në një situatë tjetër dhe këtë situatë i kemi dy momente: momenti i parë është nëse Partia Demokratike pretendon që ka ndonjë shkelje kushtetuese, megjithëse Gjykata Kushtetuese është dashur të thotë që nuk ka shkelje kushtetuese, sepse ne po zgjedhim përfaqësuesit tonë, jo përfaqësuesit e atyre, atëherë ata e dërgojnë rastin në Gjykatë Kushtetuese dhe Gjykata duhet të gjykojë mbi rastin e krijuar ose hyjmë në fazën e afateve, limiteve kushtetuese, 15 ditë presidenti i ka, 30 ditë të japë kandidatin për kryeministër dhe 15 ditë të zgjidhet kryeministri, të krijojë kushtet për t’u bërë, nëse jo, atëherë i vjen rasti shumicës tjetër.

Pra, në këto rrethana hyjmë në limite kushtetuese, në afate kohore, mbi bazën e të cilave nuk arrijmë të kemi një zgjidhje, shkojmë automatikisht në zgjedhje, nëse jo, kemi zgjidhje ose kushtetuese ose zgjidhje teknike, praktike, të cilën ne duhet ta krijojmë. Nuk kemi rrethana të tjera: ose duhet të veprojmë ose jemi në një situatë të “vdekjes” politike në aspektin e vendimmarrjes. Pse? Sepse, ata s’vijnë. Çka nëse nuk vijnë 2 vjet? Çka nëse në një situatë hipotetike pas zgjedhjeve të ardhshme do të kemi parti radikale, të cilat do të fitojnë në Kosovë dhe do të qesin kushte ekstremisht të papranueshme për ne. Ndahet skena politike në 10 parti, 15 parti, sepse ne kemi sistem proporcional dhe në Kuvend mund të hyjë secila parti, e cila merr një numër minimal për të hyrë në Kuvend. Pra, jemi në një situatë, në të cilën duhet të kemi zgjidhje politike, e cila ka pasoja kushtetuese bazë që Gjykata Kushtetuese të gjykojë, nëse dikush ankohet, por duhet të bëjmë zgjidhje. Nuk mund të presim pafundësisht Partinë Demokratike dhe aleatët e saj. Ata nuk po vijnë, ata nuk po tregojnë kur do të vijnë, ata s’po tregojnë asnjë lloj vullneti të vijnë në këtë Kuvend. Çka duhet të bëjmë ne, të presim pafundësisht apo t’i propozojmë njerëzit tanë?

Përfaqësuesit e partie politike duhet të konsultohen mes vete, LDK-ja dhe “Vetëvendosja” dhe komunitetet pakicë që të paktën komunitetet pakicë të jenë në sallë dhe të propozojnë kandidatët e tyre. Ne kemi të drejtë kandidatin tonë, ju keni të drejtë kandidatin tuaj, të tjerët kanë të drejtë kandidatët e vet. Ne nuk po i propozojmë kandidatët e PDK-së, i propozojnë vetë kur të vijnë. Por, si organizim politik Kryesia e Kuvendit së Kosovës është përfaqësim politik dhe etnik, kështu është konceptuar Kushtetuta e Kosovës. Nuk është organizim teknik për mbarëvajtje të seanceve, është organizim politik, nënkryetarët e Kuvendit përbëjnë Kryesinë e Kuvendit dhe Kryesia e

Kuvendit merr vendimet me shumicë, në këtë rast, nënkryetari i LDK-së, “Vetëvendosjes”, komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera përbëjnë shumicën, 4 me 2 dhe do të mund të hynim në një procedurë, hipotetiki është çështje interpretimi, por hyjmë në një fazë tjetër. Ne duhet të hyjmë në një fazë tjetër që ta zgjidhim njëherë e përgjithmonë këtë problem, të mos na përsëritet në të ardhmen. Kemi pasur këtë problem herën e kaluar, po e kemi tash, do ta kemi edhe herën e ardhshme nëse vazhdohet me këtë logjikë. Duhet të ndërtojmë precedentin e ri ose kërkojmë rrugë të tjera alternative, nëse dikush ka një zgjidhje, e cila është e qëndrueshme dhe e cila mund të krijojë bazë të qëndrueshme për ta zgjidhur këtë problem të bllokimit të Kuvendit, Kuvendi bllokohet sepse nuk vijnë as për të diskutuar. Çka është kjo logjikë kështu? Si ndërtohet logjika kështu?

Mua më pëlqej deklarimi i zotit Konjufca, i cili tha ne do të jemi në seancë edhe nëse ata e propozojnë Kadri Veselin, edhe këdo që ata e propozojnë, është e drejtë e tyre, a e votojmë ne a s’e votojmë është çështje tjetër. Është çështje individuale, grupe, politike se kënd e votojmë e kënd s’e votojmë. Por, e drejta e propozimit është e drejtë e tyre, u është dhënë nga Gjykata Kushtetuese me interpretimin që e ka bërë, prandaj në këto rrethana ne duhet ose të gjejmë konsensus politik mes dy forcave kryesore, që janë LDK-ja dhe “Vetëvendosja” nga radhët e shqiptarëve, ose ta thyejmë diqysh këtë status quo-n. Status quo-ja po e dëmton rëndë interesin e vendit. Me këtë status quo nuk ecet përpara, me këtë precedent, i cili është ndërtuar në vitin 2014, nuk ecet tutje, duhet thyer status quo-në.

Që ta thyejmë status quo-në, duhen ide kreative, ide mbi të cilat mund të punohet, mund të ndryshohen, por jo të qëndrojmë në status quo. Me status quo nuk ka avancim, sepse e kemi krijuar logjikën se gjithsecili mund të shitet, sepse PAN-i po këqyr kënd ta blejë. Kë, bre, ta blej? Kërkon s’do ta blejë, hiç, po të ishte shitur dikush, do të ishte shitur deri sot. Kush është shitur? Kurrkush! Çka është ky diskurs publik: u shit ky, u shit ai, po shitet ky, po shitet ai. Cila është vlera që po transmetojmë ne? Se gjithçka është në shitje këtu, se gjithçka mundet të blihet. Jo, jo, ky është Kuvend ku ne përfaqësojmë mbi bazën e një ideali, mbi bazën e një vlere, me të cilën kemi konkurruar dhe pastaj mbi bazën e saj ne duhet të qeverisim, por jo të krijojmë psikologji sikur gjithçka këtu nuk ka vlerë asnjë gjë, gjithçka mund të shitet, gjithçka është e blerë. Këtu është përfaqësimi i shoqërisë kosovare, me të mirat dhe të këqijat e veta. Kjo është shoqëria jonë, kjo që po shihet këtu, nuk është ndryshe, këto janë vlerat që ne i përfaqësojmë, kështu që të nxjerrim më të mirën, në mënyrë që t’i japim më të mirën vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë vetëm dua ta them këtë, para se ta jap fjalën, Arbër. Një minutë, të lutem, më fal!

Propozimi i Arbenit është mjaft interesant, por Rregullorja e Kuvendit nuk na e mundëson një zgjidhje të tillë, sepse nënkryetarët e tri partive me shumicë të deputetëve që kanë në Kuvend zgjidhen në një pako, përnjëherësh. Ndërsa, në pako të veçantë zgjidhen minoritetet dhe Lista Serbe. Në këtë rast, na mungon PAN-i që të jetë kjo pako complete për t'i zgjedhur nënkryetarët.

E vëmë në diskutim, e debatojmë, por... Rregullorja nuk e lejon. Të lutem, zoti Arbër Rexhaj. Le të bëhet gati Armend Zemaj.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Përshëndetje, të nderuar mysafirë!

Qytetarët e Kosovës në zgjedhjet që kaluam kanë zgjedhur Lëvizjen “Vetëvendosje” tashmë subjektin politik më të madh në nivel vendi. Kjo nuk është vetëm një fitore e zakonshme e qytetarëve, por është një fitore e jashtëzakonshme e tyre kundër PAN-it, triumf i vetëdijes qytetare kundër kapësve të shtetit dhe klientelizmit gjithandej vendit tonë.

PAN-i nuk vjen, sepse atë e kanë mposhtur jo vetëm numrat, të cilat me një gjuhë aspak të dinjitetshme i quan dhe i etablon deputetët si numra. PAN-i nuk vjen, sepse atë e ka mposhtur qytetari i Republikës sonë, një republikë e cila duhet të rilindë. Dhe kjo republikë nuk rilind me PAN-in, as me numrat e PAN-it. Kosova ka nevojë për ndryshim, rilindje, një perspektivë për zhvillim të gjithmbarshëm shoqëror dhe shtetëror.

Ky moment në të cilin ndodhemi është momenti më i rëndësishëm pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ku u manifestua vullneti popullor për ndryshime radikale në institucione, i realizuar si ndëshkim popullor kundër qeverisjeve kriminele, të cilat e kanë dëmtuar qytetarin dhe shtetin tonë. Dhe, ky është vetëm fillimi, sepse tashmë qytetarët kanë vendosur për ndryshimin.

Vullneti për ndryshim nuk ndalet me bllokada të qëllimta dhe bojkote të institucioneve demokratike, veçanërisht kur ato bëhen nga hipokritët që çirren si institucionalistë të betuar. Ata tashmë nuk i frikësohen vetëm “Vetëvendosjes”, por edhe qytetarëve të vetëvendosur. Prandaj, bllokimi është arma e tyre e fundit. Nuk do të mund të bllokojnë në pafundësi, sepse në fund qytetari ka për t'i bllokuar dhe nxjerrë nga vrimat ku janë fshehur e nuk vijnë këtu. Ai do t'ua japë mësimin, siç ua ka dhënë edhe tani.

Në udhëkryqin politik në të cilin po tentojnë ta ngufasin Kosovën do të bëhet kthesa historike, që përfundimisht do ta çlirojë këtë vend nga bandat kriminele, sepse ne e dimë, ata e dinë, të gjithë e dimë se këtu veç vonesa mund të ketë, por assesi për ta nuk do të

ketë shpëtim. Janë bërë bashkë Kadri, Ramush, Fatmir, të cilët nuk shohin asgjë tjetër, pos pushtetit. Pushtet për vete, varfëri e mjerim për qytetarët. Kosova ka nevojë për rilindje dhe këtë nuk mund ta bëjë as Ramushi, as Kadriu, as Fatmiri. Këtë nuk mund ta bëjnë as të tre bashkë, këtë nuk mund ta bëjë, pra, mendësia e tyre politike. Këtë mund ta bëjnë vetëm ata që e kanë marrë besimin e qytetarit, pra Lëvizja “Vetëvendosje”. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Armend Zemaj e ka fjalën. Ismail Kurteshi le të bëhet gati!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë që jeni të pranishëm,

Mysafirë dhe të gjithë ju që po shprehni interesimin për atë se çfarë po ndodhë në seancën plenare, sidomos qytetarët e vendit, të cilët me të drejtë janë shqetësuar, mbi të gjitha janë shumë të interesuar që zgjedhjet e 11 qershorit, pavarësisht mënyrës se si kanë ardhur dhe çfarë kanë derivuar, të ketë konstitutim të institucioneve, sidomos të fillojmë me Kuvendin dhe të përfundojmë me zgjedhjen e Qeverisë.

Ajo që shihet, është e qartë dhe që po theksohet, por para se të dal te kjo nuk jam shumë i interesuar që këtë ta shndërrojmë në monolog, sepse do të duhej të kishim debat dhe të mos e shndërronim në diskutime dëshirash apo edhe skajshmërisht në demagogji politike, por të kërkojmë t’i ofrojmë zgjidhje edhe Kuvendit, por të propozojmë diçka që të mund të ecim më tutje. Sigurisht që barra tani rastësisht i bie sipas moshës, kryesuesit të seancës, por edhe grupeve politike që po shprehin interesimin që të jenë prezentë këtu, qoftë grupit tonë LAA si koalicion apo Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Përbërja PAN-iste, për çudi, kuptohet me shumicën e saj parlamentare, edhe ato që u thanë edhe me Listën serbe, plus Radojçiqin e të tjerët, dëshiron që t’ia imponojë pakicës zgjedhjen e kryetarit dhe të Qeverisë. Dhe, kjo është më se e qartë, tash e kanë kuptuar edhe qytetarët e vendit dhe nuk do koment tjetër.

Por, zoti kryesues i seancës, unë besoj që ju duhet të thërrisni një takim konsultativ, pavarësisht a i pëlqen “Vetëvendosjes” apo Lidhjes Demokratike të Kosovës, me grupet politike që janë në Kuvendin e Kosovës. Unë e kam parë edhe në të kaluarën, që kjo pak është zgjeruar në subjekte politike. Kjo duhet të dallojë, nëse thirret brenda Kuvendit, janë grupet politike që janë të përfaqësuar, subjektet politike kanë të drejtë pas konstitutimit të Kuvendit të themelojnë grupe të tjera politike, nëse e ndiejnë veten edhe në emërtimet e tyre të subjekteve politike.

Dhe, ky takim konsultativ që po kërkohet nga të tjerët, besoj se duhet të ketë një adresim edhe te ju, që ju në këtë thirrje t’i adresoni tri çështje se çka po dëshirojmë. A po

dëshirojmë që të imponohet kandidati për kryetar? A po dëshirojmë që t'i imponohet shumicës kandidati për kryeministër? Apo dëshirojmë që t'i lëshojmë rrugë pakicës që t'i zgjedhin organet edhe të Kuvendit, edhe të Qeverisë? Domethënë, këto tri pyetje besoj se duhet t'ia adresoni ndoshta kërkesës për takim konsultativ.

KRYESUESI: Më falni që po ndërhyj, unë ua bëj këto tri pyetje, por as të mos shkojë mendja që ata të japin përgjigje në këto tri pyetje.

ARMEND ZEMAJ: ...sigurisht, zoti kryesues, edhe deputetët, por edhe grupet politike duhet ta kenë një përgjigje për çka thirret një takim konsultativ. Jo vetëm për fontanë dëshirash apo për paragjykim, se duhet shtyrë për diçka tjetër. Në fund të fundit, edhe kërkesa për të shkuar në zgjedhje do të ishte demokratike dhe do të kishte një kuptim për të qenë pjesë e debatit, po qe se ata me të vërtetë e kanë këtë guxim politik apo kanë mendim tjetër.

Këtu dolën dy propozime që janë shumë serioze, nga dy grupe politike, por që kërkojnë veprim dhe tash barra na bie neve këtu që jemi të pranishëm dhe që po jemi pjesë e mbarëvajtjes apo vazhdimit të seancës konstitutive. Duhet të ketë veprim dhe as ne nuk mund të qëndrojmë kështu duke bërë monolog me vetveten apo duke i lodhur qytetarët. Pati edhe tema të reja që janë interesante dhe besoj se në të ardhmen me konstitutimin e institucioneve të Kosovës do të jenë pjesë e debatit, sepse po zgjerohet kërkesa edhe për të kaluarën, edhe për vrasjet politike, edhe për sundimin e rendit dhe ligjit, edhe për kërkim faljeje kush çka ka bërë në të kaluarën dhe me kë ka qeverisur. Kjo do të jetë në mënyrë shumë demokratike dhe qenësore, por sigurisht në interes të qytetarit dhe të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Të lutem! E ka fjalën Ismajl Kurteshi dhe ju lutem, këto biseda të mos na shndërrohen në biseda, si të them, të bëjmë muhabet "kotnasikoti", të mundohemi të japim kontribut për problemin në të cilin gjendemi. Urdhëro! Le të bëhet gati Ali Lajçi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë deputetët, për mysafirët dhe qytetarët e Kosovës.

Koalicioni PAN, të gjithë e dimë, se e ka të drejtën që ta propozojë kandidatin për kryetar të Kuvendit, por çuditërisht ata nuk po e shfrytëzojnë këtë të drejtë. Po ashtu, dihet se deputetët e Koalicionit PAN dhe të minioroteve janë të obliguar të marrin pjesë në këtë seancë dhe ata nuk po e përmbushin obligimin e vet, veprime të çuditshme apo jo!

PAN-i po kërkon konsultime, por në konsultime po kërkon një kohë tjetër për konsultime, kështu që konsultimet i ka shndërruar në mjet për të blerë kohë. Edhe unë si shumë

deputetë e qytetarë të Kosovës i bashkohem ftesës që PAN-i të vijë këtu në Kuvend dhe ta propozojë kandidatin e tyre për kryetar të Kuvendit. Është krijuar një përshtypje, sipas meje e gabueshme, se tanimë çdo gjë është në duart e PAN-it dhe PAN-i nuk është shumicë. PAN-i është një e treta, bile më pak se një e treta e Kuvendit të Kosovës. Unë mendoj se deputetët e vullnetit të mirë, të cilët edhe janë shumicë në këtë Kuvend, duhet të bashkohen, të merren vesh për veprime të caktuara, që do ta nxjerrin vendin nga kjo krizë. Këtë përkushtim këta deputetë duhet ta dëshmojnë me nënshkrimet e tyre në një dokument që do ta hartojmë bashkë dhe kur t'i bëjmë 61 nënshkrim, atëherë ndërpriten të gjitha thashethemet e PAN-it se "i kanë numrat", ndërpriten përpjekjet e tyre për të shantazhuar ose për të blerë deputetë dhe vendi kështu do të dalë nga kriza.

Prandaj, unë ju ftoj edhe juve, deputetë, që jeni këtu në sallë, e që jeni për të dalë nga kjo krizë, urdhëroni t'i ndërmarrim këto hapa, të cilët e ndërpresin këtë amulli që po e shfrytëzon PAN-i dhe të gjithë ata që, si duket, interesat personale e grupeve i kanë nxjerrë para interesave të vendit dhe për këtë nuk kemi marrë besimin e qytetarëve, por ne duhet ta kryejmë obligimin ashtu siç edhe kemi premtuar para qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I kemi vetëm edhe tre diskutues dhe të mos e zgjasim më tepër. Fjalën e ka Ali Lajçi. Le të bëhet gati Naser Rugova!

ALI LAJÇI: I nderuar kryesues,
Deputetë të nderuar,
Zonja dhe zotërinj,

Këto takimet tona që janë në fushën e përpjekjeve për institucione të Republikës së Kosovës janë doemos, por gjithnjë duke pasur parasysh Rregulloren dhe institucionet, si krijohen ato. Çdo tentim për të krijuar një logjikë të juridiksionit tjetër është diçka krejt tjetër, kurse juridiksioni është ai që ekziston.

Prandaj, ne këtu kemi edhe mendime të ndryshme. Unë besoj se s'ka dert, nuk ka gjë të keqe ky debat, ani pse mungon si i tërësishëm, për të hulumtuar edhe më tej mundësitë e ndërtimit të institucioneve të Republikës për çka ka shumë nevojë.

Rregullat janë të qarta, nevojat këtu janë shumë të mëdha për institucione, por një që duhet të themi. Nuk është kjo kriza vetëm tash e Parlamentit këtu, po kemi të bëjmë me ndryshime, mund të themi, cilësore substanciale, jo vetëm grupeve e klanore, kemi të bëjmë me programe politike, kemi të bëjmë me synime për ta bërë një shtet ligjor, i cili ka munguar dhe arbitrariteti i kësaj shoqërisë sonë i vendosur në juridiksion dhe loja e grupeve të ndryshme partiake, që kanë qenë shumë smirëse, kanë bërë që Republika e Kosovës sot të jetë në gjendje të tillë edhe në juridiksion. Nuk është veç një krizë politike

e programore, e cila tashmë veç është definuar si orientim dhe përpjekjet dhe synimet e tjera që duhet të vazhdohen më tej, por është edhe Kushtetuta ajo që po sjell edhe në këtë mënyrë rolin e vet të krizës politike në ndërtimin e institucioneve.

Dualizmi kushtetues, ose ambiguiteti, është i theksuar në të gjithë kapitujt e Republikës së Kosovës, mendoj si Kushtetutë, dhe në këtë rast shih sa ka nevojë për ndryshime kushtetuese, sepse do të na e funksionalizonte shtetin. Prandaj, këtu kur jemi, PAN-i ka veç një procedurë. U tha me të drejtë, ardhjen në Kuvend ta çmojnë dhe të vijnë ta propozojnë kandidatin. Edhe këto që ne po i flasim janë fjalamani. Është procedurë e qartë, të kenë vullnet për institucione. Nuk flasim “i kanë votat” apo s’i kanë. Të respektohet procedura, të japin kandidatin, të votohet kandidati dhe të shikohet gjendja e votimit, cili është rezultati? Kjo është procedura. Nuk ka nevojë të filozofohet, siç po bëjmë gati në një mënyrë të gjithë.

Prandaj, kjo mosardhje e tyre tregon se duan ta vazhdojnë një model të vjetër me administrimin çfarë ishte dhe faktikisht ka rënë këtu e këtej nuk mund më të lejojmë qytetarët e Republikës së Kosovës një shtet të cilin nuk e kemi funksional deri tash, prandaj kanë ndodhur ndryshime. Janë bërë votimet dhe duhet të respektohen ato me ngulm.

Në këtë rast, ka edhe përpjekje, duket në nëntekstin e shumë diskutuesve, apo të partive politike e të tjera, që mund të ndërtohen institucionet dhe që bëjnë një lojë taktike, ose truke politike, për ta çuar vendin në zvarritje dhe për të pasur poste të ndryshme në hije apo nën hije, apo si detyrë dhe për të menduar në ndonjë, ta zëmë, logjikë juridike, por jo juridikion dhe në Gjykatë Kushtetuese për interpretim shkojnë vetëm vendimet e Kuvendit. Ju lutem, nuk e kemi asnjë vendim të Kuvendit.

Prandaj, në qoftë se ne supozojmë se kemi thënë... s’kemi thënë... e tjera, Gjykata Kushtetuese nuk merret me atë punë. Mendoni seriozisht për ndryshime të vendit, uluni ngadalë, sigurisht duke pritur PAN-in që ta kryejë pjesën e vet procedurale deri kur azhurohet çështja e mundësisë së PAN-it për të ardhur dhe për ta propozuar kandidatin dhe a munda ne, me të drejtë, siç u propozua, se e kishim atë mendim edhe më herët, të fillojmë të mendojmë, a mund të transferohet pushteti prej të parit në të dytin dhe në qoftë se po dhe është në diskrecionin e kryetarit të Republikës, të punojmë në atë plan, t’i mbledhim votat faktikisht me nënshkrime dhe t’i dërgohen në tavolinë kryetarit të Republikës për mundësinë e dhënies së mandatit të dytit, e që përbën votën solide për ndërtimin e institucioneve dhe përmban projekt e fakt solid për ndryshimin e gjendjes në Kosovë. Dhe, atëherë ne ta matim gjendjen dhe të ecim.

Ndryshe, edhe ndonjë konstituim i ndonjë qeverie pa shumicën e shqiptarëve në Kosovë do të jetë jo i domosdoshëm, jofunksional, do të japë shans për kompromise dhe dorëzime të reja në kuptimin politik dhe sovran të Republikës së Kosovës, gjë që nuk duhet të lejohet dhe do të jenë kushtëzime të ardhura prej shumë drejtimesh, të cilat qysh tash Kosova i vuan ato vazhdimisht, flas në kuptim të sovranizimit të saj.

Prandaj, edhe ata duhet të jenë të vëmendshëm, koshientë, se në qoftë se nuk mund ta bëjnë me numra, e siç po duket jo, të mendojnë se nuk bëhet kiameti dhe shkojnë në opozitë si vullnetarë, si dashamirë, që të çelin rrugë për ecjen e institucioneve të Republikës, sepse modeli i tyre në fakt është demoduar dhe nuk mund të zgjasë më tej. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Naser Rugova. Le të bëhet gati edhe Rexhep Selimi.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Së pari, ne si deputetë të zgjedhur që e respektojmë Kushtetutën e këtij vendi dhe ligjet në fuqi, duhet ta kemi të qartë, jemi në seancën konstituive të Kuvendit dhe nuk kemi të drejtë debati. Profesor Hoti, si kryetar i Grupit Parlamentar të LAA-së, ju lutem t'i respektojmë normat kushtetuese dhe ligjore.

Së dyti, kjo foltore të mos tentohet të shndërrohet në një foltore, ku dikush e merr rolin e prokurorit, e është në bankën e të akuzuarit, e dikush shet moral për drejtësi, kur ne ia dimë njëri-tjetrit letrat. Në këtë kuptim, duhet të jemi të kujdesshëm, duhet të sillemi konform edhe një bontoni të të zgjedhurit të popullit. Ne jemi organ legjislativ i vendit, përderisa Gjyqësori apo edhe instancat tjera të Gjyqësorit nuk marrin vendime për dikë, sepse ne mund të japim kualifikime jo bash të hijshme për njëri-tjetrin, në kuptimin më të pozitiv të fjalës, më unifikues. I kemi lodhur qytetarët, por edhe miqtë tanë ndërkombëtarë, edhe opinionin publik, me maratona boshe në këtë foltore.

Andaj, konform Kushtetutës, zoti kryesues, e ftoni seancën, nuk ka kuorum, atëherë nuk ka debat, shkojmë tutje. Do të vijë koha kur do të konstituohen organet kompetente të Kuvendit dhe jemi të gatshëm t'i hapim të gjitha temat. Ama bash të gjitha temat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe zoti Rexhep Selimi dhe propozoj që ta përfundojmë këtë muhabet në këtë Kuvend. Urdhëro, zoti Selimi!

REXHEP SELIMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Përshëndetje për ju kolegë!

Po, është i vërtetë fakti që sot ndoshta, nëse do të ishim në rrethana krejt tjera normale, apo në rrjedhën e duhur të Kuvendit, sot nuk do të ishim, ose nuk do të duhej të ishim duke bërë debat. Por, ne nuk jemi në rrjedhën e duhur të Kuvendit, jo për fajin tonë, as për përgjegjësinë tonë, por për fajin dhe përgjegjësinë e atyre që e kanë dhe po vazhdojnë ta bllokojnë këtë rrjedhje.

Sido që të jetë, evidente është që kaluan dy muaj nga zgjedhjet. Qytetarët e Kosovës ende nuk po e marrin përgjigjen e porosisë që e dhanë më 11 qershor. Qytetarët e Kosovës kanë vendosur, e kanë përcaktuar ndryshimin me votën e tyre dhe ky ndryshim tashmë dihet nga kush po pengohet.

Në këtë rast, edhe një herë, fatkeqësisht nëpërmjet medieve tash duhet t'i thërrasim kolegët tanë deputetë që të vijnë këtu dhe ta japin kontributin e tyre në formimin e institucioneve të Kosovës. Nuk kemi kohë për të humbur, nuk kemi para për të humbur. Kemi shumë punë për të bërë. Sa e sa ligje në mandatin e kaluar janë ngutur në thirrje të interesit të qytetarëve që duhet t'i kenë ato ligje dhe nuk i kanë më. Kemi ligje në procedim, kemi shumë punë për të kryer dhe nuk i kemi kolegët tanë deputetë këtu në Kuvendin e Kosovës, që ne t'i hedhim hapat e duhur.

Pyetja shekspiriane "i kanë apo s'i kanë numrat" po vazhdon të mbetet akoma, por thjesht, nëse i kanë le të vijnë, nëse s'i kanë ata e kanë një mandat, prapë le të vijnë. Pra, le të procedohet, e të mos bllokohet themelimi i institucioneve të Kosovës, që janë shumë të nevojshme.

Prandaj, unë dua t'i thërras edhe një herë kolegët e mi, ejani aty ku është vendi, në Kuvendin e Kosovës, sepse asnjë vend tjetër nuk mund ta zëvendësojë Kuvendin e Kosovës, as tryeza të tjera, e as tavolinat e kafeneve nuk mund ta zëvendësojnë Kuvendin e Kosovës.

Nuk dua të futem në debatet që edhe u thanë këtu, nuk dua të futem as në tematika të ndryshme, për shkak se do të doja që këtë debat ta zhvillojmë me ata këtu në Kuvendin e Kosovës, por gjithsesi ky Kuvend i Kosovës tash do të duhej ta kishte themeluar Qeverinë e Kosovës, dhe gjithsesi Qeveria e Kosovës do të duhej të ishte themeluar e bazuar mbi shumicën. Kushdo që e manifeston shumicën do të duhej ta bënte një gjë të tillë. Po të jetë nevoja, ne i presim këtu edhe sot, po të jetë nevoja i presim edhe nesër, por gjithsesi një ditë do të ballafaqohemi këtu dhe do të manifestojmë se kush e ka shumicën.

Dhe Qeveria e Kosovës kurrë nuk do të doja të ishte në varësi të numrave të caktuar, e aq më tepër Qeveria e ardhshme e Kosovës nuk do të duhej, as nuk do të dëshiroja, kushdo

që do ta bënte Qeverinë e Kosovës, që të ishte në kushtet e faktorëve antikushtetues, në kushtet e faktorëve antishtetërorë dhe po ashtu të ishte e varur nga kushtet që i vë në këtë rast Serbia nëpërmjet Listës serbe në Parlamentin e Kosovës.

edhe

Prandaj, nga kjo foltore edhe një herë i thërrasim kolegët tanë që të vijnë dhe ta bëjnë e ta thonë atë çfarë mund dhe duan, e mbi të gjitha, ta thonë dhe ta bëjnë atë që thanë e bënë qytetarët më 11 qershor. Faleminderit, zoti kryesues, dhe na fal në qoftë se e kemi zgjatur, por sido që të jetë, në mungesë të procedurave tjera ne e zhvilluam edhe këtë debat këtu. Rastësisht ngeli që të jem i fundit dhe të ju falënderoj në emër të të gjithë atyre që diskutuan deri tash. Faleminderit!

KRYESUESI: Në bazë të gjitha këtyre diskutimeve që i dëgjova, t'u them të drejtën edhe më tepër m'u mbush mendja - unë do të shkoj në atë konsultim me PAN-in të mërkurën, në orën 10:00, dhe në këtë rast, megjithatë, i ftoj përfaqësuesit e Partisë "Vetëvendosje" dhe Koalicionit LAA që të jenë edhe ata në atë konsultim, të kemi më tepër dëshmitarë se çfarë biseda po bëjmë atje, por do ta kem vetëm një kërkesë dhe një rend dite: Kur janë të gatshëm të vijnë në mbledhje dhe në seancë dhe ta propozojnë kandidatin për kryetar të Kuvendit.

Për vazhdimin e seancës do të njoftoheni me kohë. Faleminderit!

* * *

E enjte, më 24 gusht

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 3 gusht

Mbledhjen e drejton deputeti i Kuvendit, z. Adem Mikullovc.

KRYESUESI: Deputetë të nderuar,

Për fillim ju kisha lutur që me një minutë heshtje t'ia japim nderimin e fundit ish-kryeministrit të parë të Kosovës, ministrit të Punëve të Brendshme dhe deputetit të këtij Kuvendit, zotëriut, mjekut Bajram Rexhepi.

(Një minutë heshtje)

Lavdi!

Seancën e filluar më 3 gusht, e që u vazhdua më 4, 10 dhe 14 gusht, po e vazhdojmë sot. Jemi këtu ku jemi.

Në rend të ditës, atë ditë kur e kemi filluar seancën, i kemi pasur tri pika të rendit të ditës. E para ka qenë: Zgjedhja e Komisionit për Verifikimin, e zgjedhëm; Betimi i deputetëve, e bëmë betimin, dhe Zgjedhja e kryetarit dhe pesë nënkryetarëve të Kuvendit aty ngecëm, prandaj sot e kemi vetëm këtë pikë të rendit të ditës - Zgjedhja e kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe e pesë nënkryetarëve.

Në sallë janë 94 deputetë. Kuorum kemi dhe mund të punojmë.

E ftoj përfaqësuesin e Koalicionit PAN që të urdhërojë në foltore dhe ta thotë emrin e kandidatit. Urdhëro, zoti përfaqësues!

ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryesues i kësaj seance,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Qytetarë,

Siç jemi pajtuar në takimin e fundit konsultues ndërmjet partive politike që të jemi në seancë, ne sot jemi në këtë seancë.

Dua t'i falënderoj të gjitha subjektet politike të cilat kanë marrë pjesë në një proces të tillë, meqë vendit i duhet një kulturë e konsensusit, një kulturë e koordinimit dhe një kulturë e bashkëpunimit. Politika nuk mund të funksionojë pa një bashkëpunim të mirëfilltë ndërmjet subjekteve politike. Dhe, dua ta përgëzoj zotin Mikullovc, i cili rolin e tij, funksionin e tij e ka shndërruar në një platformë të mirë që ne t'i adresojmë

shqetësimet që i kemi pasur si koalicion i përbërë nga Partia Demokratike e Kosovës, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, nga “Nisma” dhe nga subjektet tjera politike.

Natyrisht që ne jemi të interesuar që ta zbatojmë me çdo kusht, ta implementojmë me çdo kusht, ta jetësojmë me çdo kusht rezultatin zgjedhor të zgjedhjeve të 11 qershorit. Në asnjë formë nuk jemi për humbje kohe dhe për zvarritje, meqë këtë Kuvend e presin vendime të mëdha. Disa prej vendimeve të cilat nuk janë marrë në mandatin e kaluar, të cilat kanë të bëjnë direkt me jetën e qytetarëve, me zhvillimin ekonomik, dhe me progresin në vend, ne presim që ky mandat i Kuvendit të Kosovës do t'i adresojë me shpejtësinë e duhur të gjitha ato tema për të cilat qytetarët kanë pritur në këto javë të fundit.

Si koalicion, i cili e ka të drejtën për ta propozuar kryetarin e Kuvendit dhe për të konstituuar Kryesinë e Kuvendit si hap i parë, e mandej edhe kandidatët për nënkryetarë, natyrisht që kemi kërkuar kohë në këto javë të fundit, por ne, në fund të fundit, të gjithë jemi në politikë, dhe në politikë gjërat funksionojnë mes asaj se çka është e drejtë dhe e drejta është në anën tonë që ta propozojmë kandidatin për kryetar të Kuvendit dhe në mes asaj se çfarë është e mundur.

Dhe, ajo çfarë është e mundur është që ne në këto javë të fundit, por edhe sot, nuk e kemi pasur shumicën mbi 61 deputetë, ose 61 deputetë, që ta propozojmë kandidatin për kryetar të Kuvendit. Ne e kemi kandidatin, por nuk e kemi shumicën.

(Reagime nga salla)

Prandaj, kur flas se çka është e drejtë dhe çka është e mundshme, e mundshmja po ashtu nuk është në anën e askujt. Ne e kemi parë që në seancën e fundit prania e koalicionit tonë është konfirmuar me 60 deputetë. I kemi 60 deputetë, por nuk janë 61, por askush tjetër nuk e ka shumicën tjetër. Kështu që ne prapë mendojmë që na duhet edhe më shumë kohë që të mundshmen ta ofrojmë drejt asaj se çka është e drejtë.

Në këtë drejtim, dua të jem i sinqertë me qytetarët e Kosovës, por edhe me ju, që neve nga duhet kohë, na duhet edhe më tutje koordinim, por jemi shumë të vendosur që Kuvendi të konstituohet. Për më shumë, konstituimi i Kuvendit në asnjë demokraci parlamentare nuk është përgjegjësi vetëm e një shumice. Është përgjegjësi e çdo deputeti.

Zgjedhja e kryetarit të Kuvendit dhe konstituimi i Kuvendit në asnjë shtet të mirëfilltë nuk shndërrohet në një debat politik, por më shumë është një çështje procedurale.

Në këtë drejtim, unë mendoj që është përgjegjësi e të gjithëve. Nuk është vetëm e Koalicionit PAN, por është përgjegjësi e çdo subjekti politik.

Për më shumë, ne jemi të interesuar që pasi të konstituohet Kuvendit ta formojmë Qeverinë e ardhshme dhe formimi i Qeverisë nën udhëheqjen e zotit Haradinaj është një hap i pandalshëm.

Mesazhi im kryesor për qytetarët është që neve na duhet edhe pak kohë me qëllim që kur ta konstituojmë Kuvendin dhe kur ta formojmë Qeverinë vendi të lëvizë me një shpejtësi të re. Nuk jem për të zvarritur, nuk jem për të blerë kohë, por dua ta ftoj secilin në një debat sa më racional të mundshëm se si të lëvizim përpara. Faleminderit!

KRYESUESI: Me leje zoti ministër,
Sa po kërkon kohë, zoti ministër? Nuk ka përgjigje!

Zoti ministër, mirë që e pranuat. Ju lutem të më dëgjoni! Mirë që e pranuat, por nuk na thatë sa po lypni kohë?

ENVER HOXHAI: Kryesues, unë të falënderoj për pyetjen që e bëre.
Ne mendojmë që na duhet një afat kohor, më pak se dy javë dhe më shumë se 10 ditë.
Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër,
Tri herë kërkuat biseda konsultative me mua dhe unë erdha në ato biseda, edhe pse partia ime bazë ishte kundër atyre bisedimeve. Mirë që e pranuat që ju vetë e keni caktua datën 24 gusht. Tash po kërkon edhe dy javë ose dy ditë për të vazhduar edhe më tutje.

Atë ditë, në biseda konsultative thatë “Kush jeni ju që po dyshoni që ne do të vijmë në Kuvend dhe do ta kem emrin e kandidatit?” Atë ditë ju thashë, po ju them edhe sot: Ne jem deputetë të Kuvendit të Kosovës, jemi kryesisht “Vetëvendosje” dhe Koalicioni LAA. Ne jemi ata që po duam ta bëjmë konstituimin e Kuvendit, ta formojmë Qeverinë dhe Kosova të ecën përpara. Ju jeni ata që po bllokoni. Dhe, unë po ju pyes juve: Kush jeni ju? Me çfarë të drejte?

Unë nuk marr përgjegjësi, nuk kam kompetenca të përgjigjem në kërkesën tuaj, por propozoj që t’i ftoj sipas ulëseve që janë në Kuvend përfaqësuesit e partive të urdhërojnë dhe ta japin mendimin e vetë për propozimin e PAN-it.

Në këtë rreshtim, e para është “Vetëvendosje”, se populli e ka votuar më së shumti, “Vetëvendosjen” si parti e vetme, mandej vjen Koalicioni LAA, e kështu me radhë, minoritetet, Lista serbe e të tjera.

Urdhëro, përfaqësuesi i “Vetëvendosjes”, ta thotë mendimin e vetë. Zoti Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: I nderuar kryesues i seancës konstituive,
Të nderuar deputetë,

Ne jemi përfaqësuesit që nuk po arrijmë të bëhemi ligjvënës. Ne jemi deputetët që kemi ngelur pa Kuvend, e deputeti i betuar pa Kuvend të konstituuar është sikur qytetari pa shtet. Është refugjat paçka se në tokë të vet. Është sikur ne këtu pa Kuvend paçka se në sallë të Kuvendit.

Po bëhen gati dy muaj e gjysmë që prej zgjedhjeve të 11 qershorit, e shteti i Kosovës nuk ka as Kuvend, e lëre më Qeveri.

Jetojmë në kohë të hipokrizive të mëdha. Tashmë për të gjithë u bë e qartë se krerët e PDK-së e flasin atë që s’janë. Ata thoshin se i kanë numrat dhe nuk vinin në Kuvend për t’i provuar e dëshmuar. Ata thoshin se i kanë fituar zgjedhjet dhe nuk guxonin t’i nxirrnin para votës kandidatët e tyre. Por, jo vetëm kjo ata thoshin se janë institucionalistë e shtetndërtues, e në fakt ata e kanë sabotuar institucionin më të lartë të Republikës. Ata thonë se janë për demokraci, e në fakt nuk po e pranojnë votën e qytetarëve, të cilët masivisht kanë vendosur për ndryshim.

Ata thonë se janë me partnerët ndërkombëtarë, por në fakt u qortuan haptazi e ashpër prej ndërkombëtarëve për sjelljet e tyre antidemokratike dhe për sabotimin e Kuvendit.

Pra, pavarësisht fjalëve që i thonë, ata janë jo thjesht humbës të zgjedhjeve, por janë kundër institucioneve, kundër demokracisë dhe kundër modeleve të mira.

Ne kemi dëgjuar se zoti Veseli është kandidati i PAN-it për kryetar të Kuvendit. Urdhëroni zoti Veseli, matuni! Matuni! Propozojeni zotin Veseli edhe le të matet nëse i ka votat. Kuvendi duhet të konstituohet. Salla është plot. Matuni!

Më 11 qershor nuk keni dashur që të mateni si i nominuar për kryeministër i PDK-së, tash nuk po dëshironi të mateni si i nominuari i PAN-it për kryetar të Kuvendit.

Matuni!

Matuni dhe ballafaqohuni me të vërtetën!

Kosova po humb shumë prej vonesave që po ia shkakton udhëheqja e PDK-së. Tashmë prej Kosovës po tërhiqet FMN-ja, po i ndal programet e ndihmave financiare për Kosovën shkak i vonesave që i shkaktojnë bojkotuesit e Kuvendit.

Gjendemi përballë krizës energjetike për shkak të menaxhimit të keq nga të dirigjuarit e PDK-së. Jemi të izoluar nga vizat si pasojë e korrupsionit dhe mosluftimit të tij. Bankat investive nga e gjithë bota e kanë vendosur Kosovën në listën e zezë për shkak se nuk ka shtet të së drejtës dhe sundim të ligjit.

Pra, këta të njëjtit janë arsyeja pse nuk ka investime nga jashtë në Kosovë. Këta janë arsyeja pse e kemi këtë varfëri të gjerë dhe të skajshme.

Kosova dhe vetë qytetarët po humbin shumë. Shumica e ndërmarrjeve publike qendrore rajonale sot janë në prag të falimentimit. Ato janë keqmenaxhuar dhe janë vjedhur sistematikisht për një kohë të gjatë. Le të themi 8-9 vjet me radhë dhe bllokada e PAN-it po ua jep këtyre ndërmarrjeve goditjen e fundit.

Ndërmarrjet si ato të hekurudhave “Trainkos” dhe “Infrakos”, apo ndërmarrjet e ujësjellësve e të grumbullimit dhe të menaxhimit të mbeturinave janë buzë falimentimit dhe vetëm formalisht janë ende funksionale, sepse praktikisht kanë falimentuar.

Po ashtu, ka edhe raste si ai i Postës me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, ku para e ka dërguar në gjyq themeluesin dhe e ka fituar gjyqin duke i akorduar dëmshpërblimin mbi 3,6 milionë euro. Gjendja në KEK ende është më e rëndë dhe shpronësimi për mihjet e reja ende nuk është realizuar, edhe pse Qeveria ka marrë vendime për shpronësime, këto të fundit në kundërshtim me vendimin e vitit 2009, kur zona në fjalë ishte shpallur “zonë e mbrojtur”.

Meqë këtë vit për shkak të mungesës së Kuvendit nuk pati rishikim të buxhetit, aktualisht Ministria e Punës nuk i ka fondet për t’i bërë pagesat për veteranët. Për pasojë, nuk mund të lëshohen pagesat.

Më e rëndë është gjendja me barnat. Barnatorja Qendrore e Shërbimit Spitalor Klinik-Universitar i Kosovës nuk ka asnjë furnizim të ri. Andaj, Qendra Klinike Universitare e Kosovës rrezikon seriozisht në secilën klinikë të saj.

Edhe më e rëndë është gjendja në spitalet rajonale, ndërsa tashmë në qendrat e mjekësisë familjare, duke nisur nga Prishtina e në çdo komunë të madhe dhe të vogël, furnizimi me

barëra është ndërprerë. Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Spitalor Klinik-Universitar i Kosovës nuk mund të ndërmarrin asnjë veprim financiar.

Këto janë vetëm disa prej problemeve të mëdha që solli bllokada e PAN-it. Prandaj, edhe një herë u bëj thirrje të gjithë deputetëve të ndershëm dhe të përgjegjshëm, të mblidhemi që ta thyejmë bllokadën. Kosova duhet të ecën përpara.

PDK nuk po tregon interesim për ta konsumuar të drejtën e saj për ta propozuar kandidatin. Kjo nuk nënkupton që Kuvendi duhet të mbetet pa kryetar, meqenëse e drejta për t'u nominuar nuk mund të monopolizohet. Shumica jonë e deputetëve që vijmë rregullisht këtu së bashku le ta propozojmë një kandidat për pozicionin e kryetarit të Kuvendit, e më pas ta zgjedhim atë person me votat tona. Kushtetuta ia jep të drejtën ekskluzive për të propozuar një kandidat për kryetar të Kuvendit grupit më të madh parlamentar. Këtë rregull ne duhet respektuar, por së pari ky rregull duhet kuptuar.

Gjykata Kushtetuese varet nga Kushtetuta, dhe jo anasjelltas. Nuk ka dyshim se kuptimi i shprehjes në Kushtetutë është ky “secili grup që e ka shumicën e nevojshme për ta zgjedhur kryetarin e Kuvendit”, pra secili grup parlamentar që i ka 61 vota, apo më shumë se kaq. Nuk ka dyshime për këtë, sepse ndryshe nga rasti i zgjedhjes së kryeministrit, ky rregull nuk ofron zgjidhje për ndonjë bllokim të mundshëm. Kështu që duhet interpretuar në mënyrë të tillë që të mos mund të ndodhin bllokime. Interpretimi duhet të jetë progresiv në kontrast me atë që të ngujon në pat pozicion.

Prandaj, nëse PAN-i e bojkoton seancën dhe vijnë këtu që të mos rrinë, apo nëse refuzon që ta paraqesë kandidatin e vet, atëherë le ta votojmë ne tonin. E nëse PAN-i do ta paraqesë një kandidat, atëherë secila parti e bën zgjedhjen e vet, sepse nisma që po propozoj në radhë të parë e ka për synim tejkalimin e këtij bllokimi. Nëse kandidati i paraqitur nga PAN-i nuk do t'i marrë votat e duhura, atëherë kandidati ynë i përbashkët do të mund të votohet në seancë. Këta qartë nuk duan ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre.

Ne jemi të hapur për çdo propozim sa i përket kandidatit për kryetar të Kuvendit. Nëse nuk i ka votat zoti Veseli, unë jam i bindur që në mesin tuaj ka shumë kandidatë që i kanë votat. Provojeni! Provojeni, se në mesin e jush ka njerëz më të votuar se Veseli për t'u bërë kryetar i Kuvendit dhe le ta tejkalojmë këtë bllokadë.

Ne mendojmë që ai person duhet të zgjidhet në mes të deputetëve të respektuar dhe sa më pak të anshëm, sepse duhet t'i garantojë të gjitha palët se do të jetë dhe do të veprojë në atë funksion të rëndësishëm pa mbajtur anë, duke u dërguar një sinjal qytetarëve tanë se politika në Kosovë ka filluar të ndryshojë. Vendi ynë është republikë parlamentare. Kuvendi është tejet i rëndësishëm. Menjëherë pasi ta kemi zgjedhur kryetarin e Kuvendit,

duhet t'ia shkruajmë një letër Presidentit, që ai t'ia propozojë Kuvendit kandidatin për kryeministër sipas nenit 95 të Kushtetutës, pikës 1, përkatësisht 4 të këtij neni.

Presidenti do ta bënte këtë, sepse përndryshe ai do të rrezikonte ta shkelte Kushtetutën.

Të nderuar deputetë,

Ne që ishim të rregullt në të gjitha këto katër vazhdimet e seancës konstituive nuk duhet të presim. Është jo vetëm e drejtë, por edhe obligim yni që të lëvizim. Kosova po humb edhe për faktin se po vonohet ardhja e fituesve në pushtet. Kemi shumë punë me gjithë këtë papunësi. Kosova po e vuan faktin që nuk po lejohet të bëj qeveri.

Nëse “Vetëvendosje” do të ishte në pushtet, tashmë do të kishte filluar zbatimi i vizionit për shtetin zhvillimor, bashkëpunimi me mërgatën dhe me kompanitë e huaja për të sjellë investime që do ta rritnin prodhimin dhe punësimin.

Nëse “Vetëvendosje” do të ishte në pushtet, tashmë do të kishte nisur zbatimi i planit për reformë në drejtësi dhe hetimi e gjykimi i të korruptuarve që e kanë lënë vendin të pazhvilluar, popullin të papunë, e fëmijët pa bukë e pa shkollë.

Nëse “Vetëvendosje” do të ishte në pushtet, tashmë do ta kishim një shtet që ka marrëdhënie shumë dinjitoze e bashkëpunuese me ndërkombëtarët.

Partia Demokratike e Kosovës i di krejt këto. Ajo e ka kuptuar se ndërkombëtarët tashmë nuk janë më të interesuar për stabilitet pa zhvillim, e pa drejtësi siç ofron PDK-ja. Ndërkombëtarët e kanë kuptuar se edhe është më mirë për ata edhe për Kosovën stabiliteti me zhvillim dhe me drejtësi që ofron Lëvizja “Vetëvendosje”.

Kjo gjë e bën PDK-në xhelozë dhe kjo është arsyeja se pse po përpiqen me çdo kusht ta vonojnë krijimin e Qeverisë sonë. Një qeveri e “Vetëvendosjes” do të tregonte brenda pak muajsh se Kosova nuk ka nevojë për politikanë të nivelit të ulët intelektual, profesional e moral.

Një argument që nuk kam dashur ta besoj, nuk kam se si të mos e pohoj: përfaqësuesi i Koalicionit LAA për bisedime me ne për Qeverinë e re ndodhet në konflikt interesi. Ai është kryeministër në detyrë që duket se nuk ka interes për kryeministër të ri. Që prej 11 qershorit ne jemi takuar veçse një herë, më 6 korrik. Ekipet tona...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, të lutem, tonin!

ALBIN KURTI: ...janë takuar vetëm dy herë. Zvarritjes së PAN-it është e padrejtë t'i përgjigjemi me një zvarritje tonën. LDK-ja e ka emëruar Mustafën si udhëheqës të bisedimeve, e jo udhëheqës për pamundësim të bisedimeve. Nëse ai nuk takohet me PAN-in, siç edhe ka deklaruar disa herë dhe vetëm një herë është takuar me "Vetëvendosjen", atëherë shtrohet pyetja: Cilat bisedime po i udhëheq ai?

Të nderuar deputetë të Koalicionit LAA, ne e shtrijmë dorën e bashkëpunimit për harmonizimin e qëndrimeve dhe për veprimet e përbashkëta. Kemi nevojë për Kuvend e Qeveri të re, është në dorën tonë, le ta themi e le ta bëjmë!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

11 qershori ishte dita kur populli e kuptoi se ishte më i fuqishëm se shteti i kapur dhe se kapësit e shtetit. 22 tetori do të jetë dita kur populli do të veprojë që t'ua shkëpusë nga duart shtetin këtyre kapësve. U desh fillimisht të kuptohet se e kemi fuqinë që tashmë tregojmë se e përdorim atë, dhe kjo është shumë mirë për Kosovën, për partnerët tanë ndërkombëtarë dhe për të gjithë ata që janë të interesuar për një shtet me mirëqenie dhe barazi, zhvillim e drejtësi në këtë vend të globit.

Kurrë kriminelët nuk kanë qenë më të izoluar. Shqipëria zyrtare nuk është me ta, Amerika zyrtare nuk është me ta, Gjermania zyrtare nuk është me ta. Po i mbështet vetëm Vuçiqi dhe Gruevksi, por ky i fundit nuk është më në qeveri.

PAN është bërë krejt irracional prej dëshpërimit dhe po bëjnë çmenduri duke menduar se mund ta ndalin këtë gjë me metoda fëmijërore, duke mos ardhur në Kuvend, ose duke ardhur kot, sikur sot. Ne jemi të gatshëm për ta krijuar Qeverinë dhe për ta filluar punën që i ka munguar Kosovës në këto 18 vjetët e pasluftës.

Zhvillim ekonomik për punësim, luftim të korrupsionit për drejtësi, politika sociale për mirëqenie, integrim euroatlantik për ardhmëri. Tash jemi edhe afër zgjedhjeve lokale, jemi afër qeverisjes qendrore me vendin. Nuk mund të na vonojnë më shumë muaj e vite, mund të na vonojnë me javë ose muaj. Ne po vijmë qartazi, këta po shkojnë, disa porsimjegulla, e disa porsiterri. Ne jemi gjithnjë e më afër qeverisjes, e me këto vonesa tash po dukemi sikur anija, e cila teksa i afrohet bregut, kah fundi lëkundet ca para e ca prapa, lëkundet pikërisht sepse po arrin në breg. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj përfaqësuesin e Koalicionit LAA, ta dëgjojmë edhe mendimin e tyre. Më falni, zotëri, por PAN-i foli i pari, PAN-i e tha mendimin e vet. Fjalën e ka zoti Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Ne po mbledhemi për të gjashtë herë në këtë sallë, në pamundësi që t'i zgjedhim institucionet e vendit të dala nga zgjedhjet e parakohshme.

E kemi një Qeveri që është funksionale, kujdestare, për t'u siguruar që rezultatet e dy vjet e gjysmë të qeverisjes nuk degradohen gjatë kësaj periudhe të përkohshme të qeverisjes në detyrë, megjithatë vendi ka pasoja nga kjo situatë. Më lejoni t'i përmend disa prej tyre, të cilat i kemi thënë qartë në tryezën diskutuese që e kemi mbajtur para dy javësh si koalicion: është marrëveshja me Bashkimin Evropian që duhet të ratifikohet sa më parë për 70 milionë euro që pritet t'i përfitojnë qytetarët e vendit. Programi me Fondin Monetar tanimë ka përfunduar dhe ne nuk mund të tërheqim 15 milionë euro nga ai program. Në mungesë të rishikimit të buxhetit dhe ndryshimit të Ligjit për AKP-në janë rreth 100 milionë euro, projekte të ndryshme që duhet të shkurtohet për ta mbajtur bilancin buxhetor në nivel të dëshirueshëm.

Por, vendi e ka një Qeveri kujdestare dhe një kryeministër të përgjegjshëm që po kujdeset për mbarëvajtjen e punëve të saj derisa nuk themelohet qeveria tjetër. Ne kemi hyrë tanimë në muajin e tretë prejse janë mbajtur zgjedhjet dhe ende nuk është e qartë se kur mund të themelohen institucionet e vendit. Kjo situatë është krijuar nga një grupim politik që thjesht e ka monopolizuar të drejtën për ta propozuar kryetarin e Kuvendit dhe për ta çuar përpara procesin e themelimit të institucioneve të vendit.

Duhet të them edhe një herë qartë përpara jush se ky monopolizim po bëhet për shkak të insistimit të vetëm 2 individëve për të ardhur në krye të dy institucioneve të vendit me çdo kusht, duke mos ndjekur asnjë rrugë për ta realizuar qëllimin e tyre. Po të silleshin në mënyrë normale, demokratike dhe institucionale, koalicioni i udhëhequr nga PDK-ja sot duhet ta japë kandidatin për kryetar të Kuvendit, ose në këtë foltore të dalë përfaqësuesi i këtij koalicioni dhe të thotë që nuk e kanë shumicën e nevojshme as për ta zgjedhur kryetarin e Kuvendit dhe as për ta zgjedhur Qeverinë e vendit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot përfundimisht vendi po hyn në krizë të thellë institucionale. Unë mendoj që nga sot nuk mund të organizohen seanca të tjera për të konstituuar Kuvendin, përpara se të qartësohet ligjërisht rruga dhe sipas Kushtetutës lidhur me të drejtën e një grupimi politik për ta propozuar kryetarin e Kuvendit.

E dini më mirë se unë që në mandatin e kaluar Kuvendi qe shndërruar në arenë përplasjesh me gaz lotsjellës, me fyerje, me sharje nga më të ndryshmet, me sulme fizike ndaj deputetëve dhe anëtarëve të Qeverisë. Në këtë mandat ende nuk kemi filluar, procesi

i konstitutumit të Kuvendit është bërë pjesë e pazareve të ulëta politike, e ndoshta edhe të konsumimit të veprës penale të disa individëve, duke bërë presion mbi disa deputetë.

Më vjen keq që një grupim i tërë politik, i udhëhequr nga PDK-ja, i ka varur krejt shpresat e formimit të institucioneve të vendit në vullnetin dhe në angazhimin e disa, po i quaj “matrapazëve”, që punojnë për interesa të caktuara për t’i bindur disa individë për ta votuar këtë koalicion. Kjo është fatkeqësi për vendin, kjo është fatkeqësi për këtë grupim politik, kjo është papërgjegjësi e këtij grupimi politik. Kështu nuk bëhet shteti. Kështu nuk bëhen institucionet e vendit. Shteti bëhet me përkushtim, me vullnet. Institucionet bëhen me marrëveshje të forcave politike. Nëse ka marrëveshje të tillë, shkohet përpara. Nëse kjo marrëveshje nuk mund të arrihet, lëshohet rrugë dhe proceset ecin përpara.

Unë deklaroj përpara Kuvendit, para qytetarëve të vendit, se grupi ynë parlamentar do të silllet në mënyrë kushtetuese, ligjore, siç ka bërë gjithmonë në procesin e konstitutumit të institucioneve të vendit. Por, ju garantoj gjithashtu se pas seancës së sotme nuk mund të rrimë duarkryq. Do t’i konsiderojmë të gjitha rrugët ligjore dhe kushtetuese për t’i themeluar institucionet e vendit. Tryezën politike që e kemi filluar para dy javësh do ta aktualizojmë prapë, tash me pyetje të qartë se si të dilet nga kjo krizë e thellë politike dhe unë pres që në këtë tryezë të na bashkohen të gjitha grupet politike, pa përjashtim, përfshirë tash edhe Koalicionin PAN, duke qenë se është e qartë që këta nuk mund të shkojnë përpara për t’i themeluar institucionet e vendit.

I nderuar kryesues i seancës,

Ashtu siç jeni sjellë deri tash, unë nuk besoj se pas kësaj seance ka kuptim të thirret seancë tjetër. Ne duhet të ulemi në tryezën politike të organizuar nga grupi ynë parlamentar. Të gjitha grupet politike të ulemi, ta qartësojmë rrugën kushtetuese për të dalë nga kjo gjendje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëroni zoti Kadri Veseli, kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës.

KADRI VESELI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Përshëndetje korit diplomatik!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, në demokracinë tonë të re parlamentare secili prej nesh do të kishim pasur dëshirë të kemi më shumë sukses, e në të njëjtën kohë, në mënyrë që të mos kishim ripërsëritje të situatave që nuk po na bëjnë dinjitozë, ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës, por as shtetin tonë, as qytetarët tanë.

Lufta politike e ka deri diku njëfarë matjeje dhe ka deri diku edhe një logjikë, në të cilën luftohet veç sa për të fituar. Zakonisht egot i bazojnë edhe partitë politike në këtë koncept vetëm si të arrijnë të fitojnë. Deri diku e ka legjitimitetin, pavarësisht se shpeshherë politika moralin e lë shumë anash dhe shkëputet nga morali.

Unë dëshiroj të theksoj se nuk është mirë të vazhdohet që nga kjo foltore e Kuvendit të bëhen shumë abuzime, për arsye se të gjithë njerëzit, e kam thënë edhe kur kam qenë si deputet i Kuvendit dhe si kryetar i Kuvendit: mirë është të ruhem nga pak për hir të fytyrës, për hir të fëmijëve të dikujt, për hir të familjes së secilit. Secili ka diçka çka mund të flasë, secili ka nga një fëmijë që e rrit, secili ka nga një prind që mund ta ketë të mirë apo të keq, pastaj në institucionet e Republikës së Kosovës, ky është shtet i pavarur sovran, çdo gjë kontestuese është mirë të orientohet nga institucionet, organet juridike përgjegjëse, për të cilat duhet të flitet, e jo të abuzohet në foltore.

Albini e përmendi emrin tim, pastaj unë si një lider që e konsideroj shumë revolucionar, 'shoku Mao' e quaj nganjëherë, fjalim politik të përgatitur vetëm për koncept të fushatës elektorale. Milaim, mos qesh! Koncept i fushatës elektorale, as nuk i intereson çka ndodh në këtë Kuvend aktualisht. Ideja është për të qitur... këta janë të zinjte, këta e mbajnë shtetin peng. Po të mos ishte shteti, 'këta do të bien në burg', 'do t'i tërheqim zvarrë', nëpërmjet formave të tilla fëmijërore për të fituar elektorat. Po, çfarë fiton? E merr pushtetin, çka fiton? Vjen puna kë ta futësh në burg? 70 dosje, pastaj shkon e i lutet, këtu shpirtin ka dashur t'ia nxjerrë, ia ka sulmuar familjen. E ka sulmuar në Therandë me akte terroriste, e ka sulmuar këtë Kuvend. Dëgjo, e keni marrë në qafë Astrit Deharin. Derisa këtu i keni ata që e kanë ideuar dhe e kanë sulmuar.

Dëgjo, ju mund të bëni shantazh ku të doni, vetëm kini parasysh, me neve nuk ju shitet, me mua veçanërisht. Po them edhe diçka, është mirë të jemi korrektë. Ne e kemi një të drejtë kushtetuese, e cila është, por nuk bëhet kiameti se e kemi të drejtën kushtetuese. E kam thënë që ditët e para, herën e parë, po e them edhe një herë publikisht. Le të jem shumë i hapur, nuk po flas për disa që janë këtu, po flas për qytetarët e Republikës së Kosovës. Ne sot kur jemi, i nderuari profesori Enver Hoxha e tregoi. Situata aktuale politike, gjendja në këtë parlament, është 60 vota, nuk është 61. Nuk ka të drejtë askush t'i bllokojë, është e vërtetë. Unë po flas publikisht.

Kryesues, mbaj evidencë, keni edhe protokoll. Ditën që t'i bëni 61 nuk ka... Unë jam kryetar i PAN-it, ditën që t'i bëni 61, kush t'i bëjë në këtë Kuvend le ta krijojë institucionin e Kuvendit dhe kryetarin, por mos manipuloni me qytetarët. Nuk u kemi borxh! Njerëz që s'kanë bërë asgjë për atdheun. Njerëz... nuk ka pasur gjë më të rëndë për mua se sa si deputet... edhe unë një ditë kam luftuar, po të vijë puna disa, si unë kur jam rritur, kanë jetuar në edukatën që s'e kanë njohur as s'e kanë dashur Republikën e

Kosovës, kanë futur familjarë tanë në burg, të vijë puna të nxirret flamuri prej xhepi... E unë çka jam, tradhtar? Ju çka jeni, tradhtarë? Po, sikur Lista serbe ta nxjerrë flamurin e Serbisë? Çka është kjo nxitje kaq e madhe për shkatërrimin e këtij shteti? Me sakrificë është ndërtuar ky shtet.

Çka është dëmtimi, pikërisht para anëtarësimit në NATO të Malit të Zi, sulmi kërcënim fizik i Malit të Zi? Dëgjoni edhe diçka, ne jemi politikanë, në qoftë se dëshironi politikanë. Kjo foltore nuk është mirë të abuzohet. Çka janë çështje të gjyqësisë, e thërras edhe gjyqësinë, të mos struket dhe ata të cilët janë të korruptuar, pak u ka bërë “Vetëvendosje” çka do t’u bëjmë ne. Gjyqtarët dhe prokurorët e korruptuar le ta harrojnë se do të kenë imunitet ndaj nesh, për arsye se nga frika... pse të futet në burg një njeri që merr dru për mbijetesë, kurse shkelet shteti dhe njerëzit tolerohen? Sulmohet... e keni njeriun e akuzuar për terrorizëm këtu, shan çdo ditë, thuajse është si ‘baba i kombit’. Driton, të jesh krenar me babanë, të jesh shumë krenar.

Dëgjo, jam Kadri Veseli, kujt borxh s’i kam! Kush do, jam... populli e ka treguar veten në përkrahje. Të njëjtën kohë, në organe juridike urdhëroni, por mos e abuzoni vendin! Dëgjoni, ky shtet është shumë i shenjtë, nuk do ta lëshojmë aq lehtë që të manipulohet me të.

Pushtetin merre, Albin, bëji 61. Publikisht, kur t’i bëjë Albin Kurti 61 vota në këtë Kuvend, unë jam kryetar i PAN-it, do t’ia nënshkruaj të bëhet kryetar i Kuvendit dhe le të bëhet edhe kryeministër, se e ka qitur edhe kravatën si simbol i borgjezisë dhe le të bëhet! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Polemikë, Albin Kurti, do të përgjigjet. Të lutem! Ju lutem, nuk ka debat në këto seancat konstitutive. Ky nuk është debat, po flasin vetëm kryetarët ose përfaqësuesit e partive, polemikë s’ka.

ALBIN KURTI: I nderuar kryesues i seancës konstituive,

Të nderuar deputetë,

Unë e pata një pyetje shumë të thjeshtë për zotin Veseli. Pse s’po matesh? Dil, matu e shiko nëse i ke 61 deputetë?

Gjykata Kushtetuese, me vendimin e 26 gushtit 2014 jua ka dhënë të drejtën ekskluzive, jua ka dhënë veton, dil matu! Pse nuk po del të matesh? Nëse nuk do të matesh, nëse frikësohesh të matesh, atëherë unë jam i bindur që në mesin e deputetëve të PAN-it ka deputetë që i marrin 61 vota.

Rrjedhimisht, kjo nënkupton që ka deputetë në mesin e PAN-it që unë i votoj për kryetar të Kuvendit, por ju duhet ta propozoni atë. Nuk më takon mua që ta propozoj, ju takon juve që ta propozoni. Pra, ose propozojeni zotin Veseli, i cili nuk e di nëse kalon, ose propozojeni dikë tjetër që unë po ju them se ka shumë më tepër mundësi të kalojë. Nuk e kuptoj pse gjithë ky inat, pse gjithë kjo gjuhë e urrejtjes, pse gjithë kjo mëri, pse gjithë kjo ashpërsi kundër nesh?! Unë vetëm një pyetje të thjeshtë e bëra.

Ndërkaq, sa për pesë të arrestuarit e “Vetëvendosjes” në muajin gusht të vitit të kaluar, zoti Veseli porsa e vërtetoi që ky ka dhënë urdhrin që ata të shkojnë në burg. Ata u liruan dje. Në mungesë të provave u liruan dje, por ky nuk arriti ta bëjë punën e prokurorit dhe të gjykatësit deri në fund. Pra, ka dështuar në uzurpimin e sistemit të drejtësisë.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdoja tonin. Por, Albin, polemika është vetëm dy minuta, ju lutem!

ALBIN KURTI: Tjetra? Astrit Dehari është mbytur në burg. Është qeveria e “Vetëvendosjes” ajo që do ta çlirojë sistemin e drejtësisë nga Ekzekutivi dhe do të zbardhet ky rast. Por, njerëzit si Veseli nuk ke nevojë t’i pyesësh, se këta flasin vetë. Ju e patë se si, porsa në Kuvendin e Republikës së Kosovës e barazoi flamurin kombëtar shqiptar me flamurin e Serbisë. Nuk ka nevojë ky të flasë më shumë se kaq. Pa e pyetur fare, ky përgjigjet për të gjithë ata që kanë pasur dilema. Unë s’jam njëri prej tyre.

KRYESUESI: Urdhëro, zoti Kadri Veseli, por të lutem dy minuta! Më fal, të lutem, s’bën. S’kam qare pa ia dhënë. Edhe... s’ka polemikë! Urdhëro!

KADRI VESELI: Albini e vazhdoi prapë avazin e njëjtë, veç për të fituar vota, se s’i intereson asgjë.

Milaim, pse nuk e ke “znaçkën”? Mos fol, se s’ke të drejtë të flasësh asnjë send. Pse s’e ngjite “znaçkën”, “znaçkën”..., valla i Obrisë je.

Dëgjo, vetëm pak! E thashë edhe një herë shumë qartë, publikisht, për çështjen politike çka ka të bëjë me kryetarin e Kuvendit, edhe tri ditë të flitet për çështjen e kryetarit të Kuvendit, çështjen e kryeministrit, nuk kemi çka të flasim. Thjesht, vetëm mbajeni për fjalë, se dhashtë Zoti ndonjëherë që këta të dalin e ta marrin pushtetin, e zezë do të jetë për këtë Kosovë. Këta asnjë fjalë, asnjë premtim, edhe do ta harrojnë edhe Astrit Deharin, mbani mend, ditën që futen në pushtet. Për arsye se pas katër-pesë vjetësh e paskemi kapur në drejtësinë, që vërtet ka shumë korrupsion në të, pavarësisht se ka djem e vajza heronj aty që punojnë, gjyqtarë e prokurorë, po tash ne nuk e kapëm drejtësinë kur na

sulmuan fizikisht. Këta të kishin futur në burg po t'i kishim sulmuar ne fizikisht. Ne nuk e kapëm drejtësinë kur u gjuajtën në mënyrë, po flas për sulme, për atentate, nuk po flas për tjetër send, nuk m'u kanë bërë mua, s'po flas për vete, qe ku e keni kryeministrin që është ende në detyrë, thjesht. Edhe kurrkush s'ka hyrë në burg.

Shpimi i gomave në Suharekë, goditja me gurë e kolonës së kryeministrit, në të njëjtën kohë sulmi në shtëpi... Sido që të jetë, bëni çfarë të doni, por e zeza e Kosovës do të mbeteni! Keni parasysh, jeni duke manipuluar, është e vërtetë, e keni mani...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Të lutem, mundohu ta përfundosh sa më parë!

KADRI VESELI: Për besë, hiç. Kurrë më në disponim... kur kam qenë në atë foltore si kryetar kurrë s'kam mundur të flas, tash send nuk ka më kënaqësi sesa të flasësh drejtpërdrejt. Ja ku e keni... shiko... mikja e Fisnikut i mat komandantët sa milionë i kanë. Po të na qesin krejt bashkë neve çka jemi, më shumë se Fisniku s'i kemi. Krejt bashkë të na bëjnë, nja dhjetë, më shumë se Fisniku, milionerët... janë rrokur veç te UÇK-ja. Këqyre, lufta e lirisë ka qenë ajo që ka qenë, por është pjesa më e mirë e epokës sonë në këtë tokë që ka ndodhur. Nuk është mirë të fyhet askush. Në të njëjtën kohë, të luftojmë politikisht, në kuptimin njerëzor, të mos çmendemi për karrige. Bëji 61, Albin, dhe do të jesh kryetar, edhe kravata do të qëndrojë më mirë si kryeministër. Sherrin do ta shohë Kosova, do ta kthesh Serbinë në Kosovë. Kjo është.

KRYESUESI: Deputetë të nderuar,

Në këto seanca nuk ka debat.

Me kaq, po e ndërpres punën e kësaj seance. Do të njoftoheni me kohë për vazhdimin dhe çfarë do të ndodhë. Mirupafshim!

* * *

E enjte, më 7 shtator

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 3 gusht

Mbledhjen e drejton deputeti i Kuvendit, z. Adem Mikullovc.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Kërkoj falje që po presim, siç po e shihni Koalicioni PAN po na mungon, minoritetet dhe Lista serbe.

Po presim edhe pak, e të shohim çfarë do të ndodhë.

I ftoj deputetë e Koalicionit PAN të urdhërojnë dhe të ulen nëpër vendet e veta, e të vazhdojmë me punë.

Deputetë të nderuar,

Jam i detyruar të ju them një lajm: Koalicioni PAN ka kërkuar që mbledhja të fillojë në orën 10:00, e unë e caktova seancën në orën 11:00 . Tashmë kanë kaluar afro 20 minuta. Kështu që po e ndërpres punën e kësaj seance tash për tash, dhe e vazhdojmë në orën 14:00.

Mua më vjen keq, por nuk kam çfarë të bëj. Ata e kanë pasur kërkesën për në orën 10:00, por nuk janë.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, në orën 14:00

Mbledhjen e drejton deputeti i Kuvendit, z. Adem Mikullovc.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Po vazhdojmë punën e seancës konstitutive, e cila filloi më 3 gusht e vazhdoi më 4, 10, 14, 24 gusht, një rrugëtim bukur i gjatë.

Ju dëshiroj të gjithëve mirëseardhje dhe besoj që sot do t'ia vëmë pikën.

Në sallë gjenden 102 deputetë.

Kjo seancë po e vazhdon punën e vet me kërkesën e Koalicionit PAN edhe AKR-së.

Kërkoj falje që në orët e vona ju kemi dërguar thirrjen, se edhe ne e kemi marrë kërkesën e tyre vonë. Ata kanë kërkuar që seanca të mbahet në orën 10:00, unë e shtyva në orën 11:00, duke marrë parasysh se do të vijnë deputetët prej anëve të ndryshme të Kosovës.

Kur ta këqyrësh, më erdhi keq t'ju thërras aq vonë, po krejt kjo 'hallakamë' ka filluar natën vonë, ndoshta është dashur edhe këtë mbledhje ta mbajmë dikur natën!

Kemi vetëm një pikë të rendit të ditës:

1. Zgjedhja e kryetarit dhe pesë nënkryetarëve të Kuvendit

E ftoj përfaqësuesin e Koalicionit PAN të dalë dhe të na e thotë emrin e kandidatit të tyre.

ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryesues Mikullovc,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

I nderuar kor diplomatik i pranishëm në këtë seancë,

Qytetarë të Kosovës,

Më lejoni që fillimisht t'ju kërkoj falje për seancën, e cila do të duhej të vazhdonte në orën 10:00 dhe t'ju lus për mirëkuptim, me që kjo ndodhi pikërisht për shkak të vonës së disa deputetëve, të cilët u vonuan në këto minutat para se të vazhdojë kjo seancë në orën 14:00. Nuk ka pasur ndonjë arsye tjetër, po ka pasur arsyet pragmatike që një pjesë e deputetëve të koalicionit tonë nuk ishin ende në sallë dhe për atë nuk ishim në kohë. E lus për mirëkuptim secilin deputet veç e veç për këtë situatë!

Më lejoni ta falënderoj kryesuesin e kësaj seance, zotin Mikullovc, i cili natyrisht gjatë muajve të fundit ka udhëhequr këtë seancë, i cili ka menaxhuar një proces politik për disa javë dhe të cilit në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, por edhe të kolegëve nga AAK-ja, Nisma dhe nga subjektet e tjera politike dua t'ia shpreh mirënjohjen tonë.

Natyrisht që ne jemi sot që ta vazhdojmë seancën, jemi sot që ta përmbushim vullnetin politik të qytetarëve të Kosovës, ta zbatojmë rezultatin e zgjedhjeve të 11 qershorit dhe si hap i parë i zbatimit të rezultatit, implementimit të rezultatit të zgjedhjeve të 11 qershorit është natyrisht konstitutimi i Kuvendit, e konstitutimi i Kuvendit si hap të parë parasheh propozimin e kandidatit tonë për kryetar të Kuvendit dhe dua të them që kandidat yni për kryetar të Kuvendit nga koalicioni parazgjedhor dhe nga partitë e tjera politike është zoti Kadri Veseli, deputet i Kuvendit të Kosovës dhe kryetar i deritanishëm i Kuvendit të Kosovës, i mandatit të kaluar të Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në sallë janë 114 deputetë momentalisht. Po kalojmë në votim.

Propozoj që të votojmë me ngritje dore, në mënyrë të hapët, meqenëse nuk i kemi kartelat, mënyra elektronike bie prej kombinimit, kështu që propozoj të votojmë me ngritje dore dhe në mënyrë të hapët. Pajtoheni? Në rregull.

Atëherë Koalicioni PAN propozon zotin Kadri Veseli për kryetar të Kuvendit.

Kush është për, ju lutem, le ta ngrejë dorën? Ju lus, mbani dorën sa më gjatë që të numërohen sa më saktë!

Tash, ju lutem, kush është kundër këtij propozimi?

Ju lutem, a ka dikush që abstenon?

Rezultati i votim është ky:

Për kanë votuar 62 deputetë.

(Duartrokitje)

Urime!

Kundër kanë votuar 52 deputetë.

Gjithsej 114 deputetë.

Sipas Rregullores, duhet t'i zgjedhim edhe pesë zëvendëskryetarë të Kuvendit.

PAN-i, "Vetëvendosja" dhe koalicioni i Lidhjes Demokratike me Alternativën e japin nga një kandidat të nënkryetarit dhe këta tre nënkryetarë votohen në pako përnjëherë, e mandej dy të tjerët në pako tjetër.

Kështu që menjëherë, pa humbur shumë kohë, e ftoj përfaqësuesin e PAN-it ta thotë emrin e kandidatit për nënkryetar të Kuvendit.

ENVER HOXHAI: Zoti kryesues,
Nga Partia Demokratike e Kosovës kandidat për nënkryetar të Kuvendit është zoti Xhavit Haliti.

KRYESUESI: E ftoj përfaqësuesin e "Vetëvendosjes" të propozojë kandidatin e saj!

GLAUK KONJUFCA: Ne propozojmë për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës zonjën Aida Dërguti.

KRYESUESI: Faleminderit!

E ftoj përfaqësuesin e koalicionit Lidhja Demokratike dhe Alternativa!

AVDULLAH HOTI: I nderuar kryesues!

Në emër të grupit tonë parlamentar propozoj deputetin Kujtim Shala.

KRYESUESI: Pra, i dëgjuam. Sikurse thashë, këta tre kandidatë i votojmë në pako.

Kush është që këta dy zotërinj dhe një zonjë të jenë nënkryetarë të Kuvendit?

Kush është për?

A ka dikush kundër këtij propozimi? Nuk ka.

A abstenon dikush? Nuk ka as abstenime.

Atëherë domethënë këta tre kandidatë për nënkryetarë të Kuvendit, Xhavit Haliti, Aida Dërguti dhe Kujtim Shala emërohen si nënkryetarë të Kuvendit me 113 vota.

E ftoj përfaqësuesin e minoriteteve që ta japin emrin e një kandidati, mandej edhe Lista serbe jep një emër. Urdhëro!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju informojmë se Grupi Parlamentar i deputetëve nga radhët e komuniteteve joshumicë, në përbërje me komunitetin turk, boshnjak, rom dhe ashkali, më 2 gusht 2017 ka arritur marrëveshjen lidhur me renditjen sipas rotacionit për zëvendësimin e nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës, si në vijim:

Myfera Shinik, nga radhët e komunitetit turk,
Duda Bale, nga radhët e komunitetit boshnjak dhe
Danush Ademi, nga radhët e komunitetit ashkali.

Faleminderit!

KRYESUESI: Pardon, neve na duhet vetëm një emër.

Nuk ka debat, të lutem, më fal, nuk ka biseda. Dëgjoni, e di çka do të thuash. Ju i bëni kërkesën administratës së Kuvendit, e bëni radhitjen kush sa. Urdhëro!

Mos më mbaj fjalim, veç propozim, të lutem.

EMILIJA REĐŽEPI: Zahvaljujem!

Molim vas nemojte da kršite Ustav republike, član 67, tačka 4, gde je naše ustavno pravo svih manjinskih predstavnika da damo svoje kandidate. To nije ekskluzivno pravo Parlamentarne grupe "6+". Zahvaljujem!

KRYESUESI: Ju lutem nuk ka më debat kësisoj, e bëni kërkesën me shkrim, merruni vesh ndërmjet veti, drejtojani Kuvendit, Administrata e zgjedh këtë punë dhe sigurisht Kuvendi e aprovon.

E ftoj përfaqësuesin e Listës serbe të dalë dhe ta thotë kandidatin e vet.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući!

Srpska lista za potpredsednika Skupštine Kosova predlaže gospodina Slavka Simića.

KRYESUESI: Ftoj deputetët të votojnë për këta dy kandidatë të minoriteteve dhe të Listës Serbe. Kush është për, le ta ngrejë dorën, janë: Myfera Shinik edhe Slavko Simiq.

Me leje, e kam një shpjegim, si duket është një moskuptim. Nëse këta dy kandidatë, i minoriteteve dhe i Listës serbe, nuk kalojnë a nuk kanë kaluar se i kanë 59 vota, atëherë seanca nuk kryhet, po vazhdon seanca tjetër.

Unë ju lus, deputetë, fundi i fundit, në rregullore shkruan që çdo deputet në çdo votim duhet të marrë pjesë. Pro, kundër ose abstenim. Prandaj, detyrohem që edhe një herë t'i vëmë në votim.

Do të thotë, propozoj të votojmë për një kandidat nga minoritetet, Myfera Shinik dhe nga Lista Serbe, Slavko Simiq.

Kush është Për? Faleminderit!

Kush është kundër? Nuk ka kundër.

Abstenim?

Kërkoj falje, gjithsej janë 59 për dhe 48 abstenojnë. Kështu që duhet bërë një pauzë 15 minuta, të merren vesh që të votojnë. Unë nuk po kuptoj pse nuk po votojnë njerëzit? Unë vetë i pari harrova që jam i “Vetëvendosjes” dhe nuk desha të votoj.

15 minuta pauzë, të merremi vesh, duhet të votojmë të gjithë, e kemi obligim: për, kundër dhe abstenim. Shumë thjesht!

* * *

Vazhdimi i seancës, pas pauzës

Mbledhjen e drejton deputeti i Kuvendit, z. Adem Mikullovc.

KRYESUESI: Vazhdojmë me punë.

Do të thotë, kandidat për nënkryetar të Kuvendit nga minoritetet është propozuar Myfera Shinik, ndërsa nga Lista serbe, Slavko Simiq.

Ju lutem, kush është për ngriheni dorën.

Sipas votimit, për janë 61. Kush është kundër këtij propozimi? Nuk ka asnjë. Abstenim? Abstenim janë 41.

Me këtë, unë pothuajse e kreu detyrën time, vetëm që kërkoj rastin të më falni, t'i përsëndes të gjithë deputetët e 2 Korrikut, që sot 27 vjet më parë e aprovuan Kushtetutën e Kaçanikut, kudo që janë.

(Duartrokitje)

Ju falënderoj që patët durim me mua dhe m'i duruat gabimet e mia, e posaçërisht falënderoj Administratën e Kuvendit dhe zotëriun Ismet Krasniqin, pa të cilin nuk kisha mundur t'i bëj as dy fije bashkë. Faleminderit!

Kam nderin ta ftoj të porsazgjedhurin, kryetarin e Kuvendit të Kosovës, zotin Kadri Veselin, le të urdhërojë të ulet në vendin e vet.

(Duartrokitje)

Urime, zoti kryetar! Ju dëshiroj punë të mbarë!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i zgjedhur i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit!

Urime 7 Shtatori - Dita e Kushtetutës! Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni të ju drejtohem në cilësinë e kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës me falënderimin e veçantë të gjithë juve.

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Shumë të nderuar ambasadorë të vendeve mike, të akredituar në Republikën e Kosovës,

Të nderuar mysafirë,

Të nderuara medie,

Edhe një herë të nderuar kolegë deputetë,

Sot ka rastisur të jetë një ditë e veçantë për vetë Republikën e Kosovës, e cila lidhet pikërisht me historinë tonë parlamentare. Është Dita e 7 Shtatorit. Janë pikërisht 27 vjet më herët, kur deputetët trima të Kuvendit të Republikës së Kosovës arritën që pas Deklaratës së 2 Korrikut ta nxjerrin edhe Kushtetutën e parë të Republikës së Kosovës.

Një falënderim i veçantë për gjithë ata, e duke pasur parasysh se ka rastisur prapë shumë mirë, se kryesuesi i kësaj seance ka qenë një nga deputetët e mëhershëm, dëshiroj ta falënderoj atë edhe për kryesimin, por të njëjtën kohë edhe për punën dhe kontributin e tij, duke e falënderuar atë dhe të gjithë deputetët e 2 Korrikut, përkatësisht 7 shtatorit 1990.

Të nderuar të pranishëm,

Fillimisht dua të ju falënderoj për besimin e dhënë që ta drejtoj Legjislaturën e re të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Është nder i veçantë për mua që ta drejtoj institucionin më të lartë përfaqësues të popullit të Kosovës.

Si në legjislaturën e kaluar, do të përpiqem që Zyra e Kryetarit të Kuvendit ta pasqyrojë vullnetin e qytetarëve tanë për unitet kombëtar, për bashkëpunim dhe mirëkuptim ndërmjet forcave politike parlamentare.

Në radhë të parë, ajo që qytetarët presin nga ne është që situatat e kaluara t'i takojnë vetëm të shkuarës. Dallimet politike nuk mund ta justifikojnë bllokimin e shtetit. Ne jemi zgjedhur për t'i zgjidhur problemet e qytetarëve, e jo për t'i rënduar ato më shumë.

Së bashku mund dhe duhet ta kthejmë Kuvendin e Kosovës nga vend inatësh personale në vend bashkëpunimi; nga shesh akuzash në forum idesh e ligjesh për zhvillimin e

vendit. Nuk kemi kohë për të humbur. Duhet të orientohemi në çështje të interesit strategjik të vendit, forcimin e shtetit, rikthimin e madh të besimit qytetar në institucione dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarit tonë.

Çështjet që e kanë rënduar situatën politike në dy vjetët e fundit, si çështja e shënimit të kufijve, përmirësimi i raporteve me fqinjët dhe rregullimi i brendshëm administrativ i komunave në Kosovë në vendit tonë nuk janë çështje as e dëshirave, as synimeve vetëm elektorale të një partie të caktuar, as nuk mund t'i zgjidhin ato vetëm një apo dy parti. Ato janë çështje shtetërore që lidhen drejtpërdrejt me të ardhmen sovraane dhe multietnike të këtij vendi dhe me jetën e qytetarëve tanë.

Ne duhet t'i zgjedhim ato. Ne vetë, pozitë dhe opozitë, sado vonesa dhe manipulime të brendshme që mund të kemi për fitime elektorale, ne duhet të jemi të sinqertë para të gjithë qytetarëve tanë.

Ne e kemi obligim shtetëror që t'u japim rrugëzgjidhje këtyre çështjeve të mëdha.

Sa më shumë vonohemi, aq më shumë humb vendi ynë, Kosova. Sa më shumë konfliktohemi, vetëm sa ndjellim vetizolimimin dhe moszhvillimin e vendit tonë.

Është obligim i kësaj gjenerate të mbyllë çështje të hapura; është mençuri të largohemi nga kohëra dhe momente që mund të vënë dilema në shtetin tonë dhe të ardhmen e fëmijëve tanë.

Zhvendosja nga agjenda shtetërore dhe zhvillimi në agjendë konflikti mund përkohësisht të ngopë përkohësisht vetëm emocionet revanshiste të një grupi të kufizuar, por në politikë ato vetëm sa riciklohen, gjersa qytetarëve të këtij vendi vetëm sa do t'ua shtojmë problemet dhe pasigurinë.

Agjenda e zhvillimit ekonomik duhet ta zhvendosë fushën e konfrontimit tonë politik, si garë elektorale, e jo babëzia e vetëdëshmimit patriotik në rrethana lirie dhe shteti në një vend që ende i ka të freskëta, e edhe sfidat e këtij vetëdëshmimi pikërisht nga secili prej nesh vetëm 20 vjet më herët.

Të dashur deputetë,

Kolegë të pozitës dhe opozitës,

Sot, në këtë ditë të rëndësishme të konstituimit të Kuvendit, u bëj thirrje që t'i harmonizojmë qëndrimet në 5 çështje jetike për progresin e shtetit tonë.

1. Të kemi qëndrim unik për implementim e reformave që mundësojnë zhvillim ekonomik dhe punësim,
2. Të kemi qëndrim unik në implementimin e reformave në arsim dhe shëndetësi,
3. Të kemi qëndrim unik për krijimin e Ushtrisë së Kosovës,
4. Të kemi qëndrim unik në implementimin e kriterëve për liberalizimin e vizave.
5. Të kemi qëndrim unik për agjendën tonë të integritit euroatlantik dhe për dialogun me shtetin fqinj, Republikën e Serbisë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Secili prej nesh në këtë sallë është i domosdoshëm, sepse secili e përfaqëson një pjesë të vullnetit të qytetarëve.

Konsensusi është i mundshëm dhe i domosdoshëm, sepse qëllimi që na bashkon është fuqizimi i shtetit të Kosovës. Ne duhet ta bëjmë këtë. Ne jemi të obliguar ta bëjmë këtë. Për hir të qytetarëve tonë, për hir të fëmijëve tanë dhe për hir të ardhmes së kombit tonë. Na priftë e mbara. Faleminderit!

(Duartrokitje)

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni të bëjë edhe një njoftim: Unë vetëm në minutat e parë pas përfundimit të kësaj seance konstituive, si kryetar i Koalicionit parazgjedhor PAN, do të bëj mandatimin e kryeministrit të ardhshëm të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, dhe pres shumë shpejt, do të thotë orientimisht ditën e shtunë që ta kemi seancën e konstituimit edhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Urime të gjithëve! Dalshim faqebardhë! Faleminderit! Me këtë mbyllet seanca.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*